të mund të shoqërohen në gjykatë, veçanërisht kur bëhet fjalë për gjykime në qytete jashtë zonave ku janë të vendosura vetë institucionet ndëshkuese-përmirësuese, por shumë i rëndësishëm është fakti se gjykatat, sidomos ajo në Shkup, ballafaqohen edhe me situata në të cilat ndodhin përputhje kohore dhe hapësinore të disa gjykimeve me disa raste gjyqësore të nivelit të lartë. Ndonjëherë bëhet fjalë për pengesa teknike, ndonjëherë për shkaqe sigurie, por sido që të jetë, kjo vetëm e potencon nevojën për mbështetje më të madhe logjistike dhe organizim në sistemin e funksionimit dhe koordinimit të institucioneve që veprojnë në përputhje me LPP-në. Në fakt, ky është një problem që po ndodh për të katërtin vit radhazi. Mirëpo, ajo që vërehet në mënyrë plotësuese gjatë evidentimit të personave që mungojnë në procedura në krahasim me vitet e kaluara është ndarja e kategorisë "tjetër", për arsye të thjeshtë se përqindja e kësaj arsyeje për shtyrjen e shqyrtimeve nuk ishte fare e papërfillshme. Pasi u futën dy kategori të reja të "mungesave" nga shqyrtimet, është evidentuar mungesë e shpeshtë e dëshmitarit ose ekspertit në procedurë - në 92 nga shqyrtimet e ndjekura, por edhe e të dëmtuarit në procedurë - 72 shqyrtime. Duhet të paralajmërojmë se kjo nuk është gjithmonë arsye për shtyrjen e shqyrtimeve sepse këta janë persona, prania e të cilëve, sipas ligjit, nuk është e detyrueshme për zhvillimin e procedurës, por në përqindje të madhe këto mungesa ndikojnë edhe në rrjedhën, gjegjësisht dinamikën e zhvillimit të procedurës. Në masë të madhe, këto mungesa janë rezultat i mosfunksionimit të shërbimeve për dorëzimin të thirrjeve dhe e mosshfrytëzimit deri në fund të burimeve të MPB-së gjatë thirrjes së këtyre personave.



Grafiku nr.4


Në kontekst të paraleles që u përmend, në paraqitjen grafike nr. 5 të dhënë më poshtë, janë paraqitur qartë rrethanat për mungesën e personave dhe të palëve të domosdoshme në procedurë. Kështu, nëse ajo analizohet me kujdes, mund të vërehet se në 3 vitet e fundit dominon mungesa e të akuzuarit në procedurë, e menjëherë pas tyre e mbrojtësve në procedurë, ndërsa pastaj vjen prokurori publik.



Grafiku nr.5

Megjithatë, nëse bëjmë një analizë individuale të këtyre parametrave për mungesë, do të vërejmë se në shumicën e tyre ka përmirësime, por gjithashtu i qartë është edhe kthimi prapa. Në grafikon nr. 6 të dhënë më poshtë është paraqitur përqindja e mungesës së aktorëve të rëndësishëm në procedura në 3 vitet e kaluara, dhe se si ky faktor, i cili ndikon në një farë mase në shtyrjen e shqyrtimeve, i përfaqëson atë me përqindje. Në fakt, sa i përket mungesave të të akuzuarve në procedurë, vërejmë një tendencë të lehtë përmirësimi, kështu që nëse kjo përqindje është dyfishuar në vitin 2017, (45%) kundrejt asaj në vitin 2016 (22%), në vitin 2018 kjo përqindje është zvogëluar në 39%. Për më tepër, sa i përket përqindjes së mungesës së mbrojtësve në procedurë, edhe pse ajo është rritur për disa herë në vitin 2016 (6%) në krahasim me vitin 2017 (24%), në vitin 2018 ajo përsëri ka shënuar rënie të vogël në 20%, e po ashtu ka përmirësim në përqindjen e mungesës së prokurorëve në procedura, gjegjësisht në shqyrtimet e vëzhguara në vitin 2016 ajo është 7%, në vitin 2017 ajo është rritur trefish dhe arrin në 23%, ndërsa në vitin 2018 ajo u zvogëluar në 12%. Mirëpo, ajo që brengos më së shumti është rritja e përqindjes së shqyrtimeve në të cilat këshilli gjyqësor, i cili vendos për lëndët është me përbërje jo të plotë. Kështu, ky numër rritet vazhdimisht vit pas viti, me ç'rast kulmin e ka arritur në vitin 2018 dhe është 8% e shqyrtimeve të ndjekura.

Mungesat në %




Grafiku nr.6

Edhe pse përbërja jo e plotë e këshillit gjyqësor në mënyrë të pashmangshme rezulton me shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor, vetëm në një gjykatë themelore, në Gjykatën Themelore Prilep, nuk është regjistruar asnjë seancë që është shtyrë pikërisht për këtë arsye. Në 8 gjykatat e tjera ky numër ndryshon. Gjykata Themelore në të cilën është regjistruar numri më i madh i shtyrjeve të shqyrtimeve për shkak të kësaj rrethane është ajo në Ohër (10 shqyrtime të shtyra), që ndoshta mund të tregojë se ka mungesë të kuadrit gjyqësor, por rastet e tilla nuk mungojnë as në gjykatat në Strumicë (5), gjegjësisht në Shkup (5 shqyrtime të shtyra). Në rastin e Gjykatës Themelore Shkup, ndoshta më legjitim do të ishte konstatimi se kjo është rezultat i vëllimit shumë të madh të punës të gjykatës, e sidomos duke pasur parasysh faktin se në këtë gjykatë zhvillohet edhe numri më i madh i shqyrtimeve gjyqësore të profilit të lartë gjatë vitit.

■ E DREJTA PËR AVOKAT MBROJTËS

Duke pasur parasysh faktin se e drejta për avokat mbrojtës është me rëndësi thelbësore për ushtrimin e të gjitha të drejtave të mëtejshme të personave të akuzuar në procedurë, por edhe garanci se shteti të akuzuarit nuk do t'ia pamundësojë ndonjëherë nga të drejtat e parapara, LPP-ja i jep përparësi të lartë kësaj të drejte të të akuzuarve. Përveç kësaj, po të analizohet edhe nga prizmi i parimit të "barazisë së armëve", prania e avokatit në procedurë është parakusht edhe për zhvillimin e procedurës korrekte dhe të drejtë. Por, megjithëse LPP-ja jonë e garanton këtë të drejtë, i lë të lirë personat e akuzuar që ta zgjedhin avokatin e tyre mbrojtës apo edhe a do të kenë avokat mbrojtës gjatë procedurës. Natyrisht, ky rregull ka edhe përjashtim, edhe atë kur bëhet fjalë për mbrojtje të detyrueshme të paraparë në nenin 74 të LPP-së, ku ligji kërkon prani të detyrueshme të avokatit mbrojtës në procedurë, dhe kjo i referohet rasteve kur i akuzuari është memec, i shurdhër ose i paafte që vetë të mbrohet me sukses, ose kur është përcaktuar masa e paraburgimit, si dhe në qoftë se kundër tij zhvillohet procedurë penale për vepër penale për të cilën në ligj është paraparë dënim me burgim të përjetshëm, atëherë ai duhet të ketë avokat mbrojtës që në shqyrtimin e parë.

Pikërisht në grafikun nr.7 të paraqitur më poshtë shihet numri i personave të akuzuar të cilët (nuk) kanë qenë të shoqëruar nga avokati mbrojtës gjatë procedurës, që është ngritur kundër tyre. Prej tij, në mënyrë të pashmangshme mund të konstatohet se një numër i madh i personave të akuzuar, 458 gjegjësisht 81% prej tyre, në gjykim kanë marrë pjesë në prani të avokatit mbrojtës, 54 persona, gjegjësisht 9%, nuk kanë pasur avokat mbrojtës, ndërsa për 66 personat e tjerë apo për 10% të tyre, nuk ka të dhëna.




Grafiku nr.7

Ajo që është interesante për t'u theksuar është fakti se vëzhguesit kanë identifikuar gjendje në të cilën në 6 lëndë që janë zhvilluar në procedurë të rregullt, e cila në fakt parasheh zhvillimin e procedurës për vepra më serioze penale, të tilla për të cilat është paraparë dënim me burg prej mbi 5 vjetësh, të akuzarit kanë qenë pa avokat mbrojtës.

PROCEDURA E SHKURTUAR

Procedurat e shkurtuara janë lloji i veçantë i procedurave që zbatohen në përputhje me LPP-në. Ato përfshijnë një grup të llojeve të ndryshme të procedurave dhe supozojnë një formë të thjeshtuar të procedurës penale. Në këtë grup procedurash, përveç procedurës për sjelljen e aktgjykimit në bazë të marrëveshjes ndërmjet prokurorit publik dhe të dyshuarit, është e përfshirë edhe procedura e ndërmjetësimit, në të cilën merr pjesë një person i tretë i veçantë - ndërmjetësi dhe procedura për lëshimin e urdhrit ndëshkues me të cilin propozohet dhe shqiptohet një sanksion i caktuar në rast se ekzistojnë prova të mjaftueshme për veprat penale që bien nën kompetencën e gjyqtarit individual. Megjithatë, edhe përkundër faktit se bëhet fjalë për procedurë të shkurtuar, "më të lehtë", duke pasur parasysh se ajo zbatohet për lëndë për të cilat është paraparë dënim me para ose dënim me burg deri në 5 vjet, supozohet se i akuzuari nuk do të sillet në pozicion tjetër të procesit, varësisht nga pesha e veprës penale për të cilën akuzohet⁴.

Nga paraqitja grafike nr.8 që është dhënë më poshtë, mund të vërehet se nga numri i përgjithshëm prej 300 lëndëve të vëzhguara, 60% prej tyre janë zhvilluar në procedurë të shkurtuar, 24% në procedurë rregullt, ndërsa për 16% të tjerat nuk kemi të dhëna.



Grafiku nr.8

Kjo paraqet një lloj raporti konstant midis procedurës së rregullt dhe asaj të shkurtuar, duke i marrë parasysh të dhënat statistikore nga viti i kaluar, të cilat tregojnë se procedura e shkurtuar është zbatuar në 75% të lëndëve, kundrejt 25% të tyre që janë zhvilluar në procedurë të rregullt, por është e pashmangshme të konstatohet se këtë vit kemi një rënie të lehtë të këtij numri prej rreth 10%.


⁴ Kallajxhiev G., Llazhetiq G., Nedellkova L., Denkovska M., Trombeva M., Vitllarov T., Jankullovska P., Kadiev D., Koment i Ligjit për Procedurën Penale, OSBE, Shkup, 2018

MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË AKUZUARIT

Pjesë e pashmangshme e analizës për vlerësimin e procedurës së drejtë është edhe pjesa që ka të bëjë me zbatimin e masave për sigurimin e pranisë, si njëra nga masat më të problematizuara, që nënkuptojnë kufizimin më të madh ligjor të të drejtave të garantuara me Kushtetutë për gjykim të drejtë të personave të akuzuar gjatë procedurës penale⁵. Mu për këto arsye, edhe këtë vit temë e analizës ishte shpeshësia e zbatimit të këtyre masave, nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga vëzhguesit tanë, si dhe vlerësimi se këto masa a zbatohen në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligj, a janë këto masa të mbështetura në mënyrë adekuate me prova me të cilat arsyetohet domosdoshmëria e tyre, si dhe a ka bërë gjykata përpjekje të mjaftueshme për rivlerësimin kritik të këtyre masave dhe/ose se a janë zbatuar ato vetëm në rastet e domosdoshme.

Sikurse edhe në analizat e deritanishme, edhe këtë vit temë e analizës është zbatimi i të gjitha masave për sigurimin e pranisë, që janë paraparë në nenin 144 të LPP-së. Kështu, nga 415 seancat e vëzhguara për 300 lëndë kundër 611 personave të akuzuar, prania e personave të akuzuar është siguruar me masa për sigurimin e pranisë në 74 seanca gjyqësore. Me këtë rast, nga numri i përgjithshëm i masave për sigurimin e pranisë, masa më e rëndë, paraburgimi u zbatua në 20 lëndë për 29 persona të akuzuar, ndërsa masat më të lehta për sigurimin e pranisë u përcaktuan në 54 seanca të 32 lëndëve.

Në krahasim me të dhënat e vitit të kaluar,⁶ mund të përfundojmë se ka një rritje të lehtë të masave më të lehta për sigurimin e pranisë, si dhe rënie në zbatimin e masës së paraburgimit. Kështu, për dallim nga viti i kaluar kur masa e paraburgimit është përcaktuar në 40 lëndë, këtë vit paraburgimi është përcaktuar në 20 lëndë të vëzhguara, ndërkohë që mund të vërejmë një rritje të konsiderueshme prej 17 në 54 seanca të 32 lëndëve, në të cilat prezenca e të akuzuarit është siguruar përmes ndonjë mase më të lehtë për sigurimit e pranisë (grafiku nr.9).



Grafiku nr.9

5 Shih: Fenwick Helen, Civil Rights and Human Liberties, 4-th ed. Ruthledge-Cavendish, 2007, fq. 58-59.

6 Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", Shkup, Misioni i OSBE-së - Shkup, 2017, fq.12.

Madje edhe sikur të hiqet masa e arrestimit si masë tradicionalisht më e lehtë nga masat për sigurimin e pranisë dhe e cila ende konsiderohet si thirrje e vërtetë⁷ ose si pararendëse e masave të tjera më të rënda për sigurimin e pranisë, kemi një rritje të qartë në zbatimin e masave më të lehta për sigurimin e pranisë në krahasim me vitin e kaluar, gjegjësisht kemi rritje prej 17 në 43 seanca. Me këtë rast, madje edhe sikur t'i marrim parasysh të gjitha rrethanat me të cilat do të relativizohet përfundimi për rritjen e zbatimit të masave më të lehta, si për shembull rritja e seancave të vëzhguara, nga 312 në 415 këtë vit, që është rritje prej 25%, ose llojin e veprave të vëzhguara penale, që sipas kësaj është edhe rritje e pritur në zbatimin e masave për sigurimin e pranisë në përzgjedhjen e rastësishme të lëndëve, megjithatë përfundimi mbetet i pandryshuar. Në fakt, madje edhe atëherë kur numri i seancave të vëzhguara rritet për një të katërtën, gjegjësisht për 25% në kushte të përafërsisht të njëjta të shpërndarjes së veprave penale sikurse edhe vitin e kaluar, megjithatë rritja në zbatimin e masave më të lehta është më shumë se dy herë. Nëse duam të jemi të saktë deri në fund, mund ta krahasojmë edhe numrin e seancave nga ky vit në krahasim me numrin e seancave nga viti i kaluar, me ç'rast do ta barazonim vlerën e ndryshueshme - numrin e seancave me atë të vitit të kaluar, gjegjësisht nëse rezultatin prej 43 seancave e zvogëlojmë për një të katërtën, atëherë edhe herësi prej 31 seancave përsëri e gjeneron përfundimin e njëjtë. Prandaj, me kënaqësi mund të konstatojmë se ka rritje të konsiderueshme në përdorimin e masave më të lehta për sigurimin e pranisë edhe atë për 14 seanca më shumë se sa në vitin e kaluar ose, e shprehur në përqindje, rritja në këtë rast është 77%.

Megjithatë, kjo përqindje marramendëse do të duhej gjithmonë të konsiderohet në raport me përqindjen e përgjithshme të lëndëve të vëzhguara, kështu që vetëm në 10% të lëndëve prania e të pandehurve është siguruar përmes masave më të lehta për sigurimin e pranisë, analizuar pa masën e arrestimit, e nëse e përfshijmë edhe këtë masë, atëherë përqindja e zbatimit të masave më të lehta për sigurimin e pranisë do të arrinte në 12% të numrit të përgjithshëm të seancave të vëzhguara.


Ndërsa sa i përket masës së paraburgimit, këtë vit kemi rënie në krahasim me vitin e kaluar, gjegjësisht kemi rënie prej 40 lëndëve në 20 lëndë. Nëse bëhet analiza e njëjtë edhe për numrin e atyre lëndëve në të cilat është përcaktuar paraburgimi, në raport me të gjitha seancat e vëzhguara, atëherë mund të përfundojmë se paraburgimi është vërejtur në 20 seanca, kështu që rënia në zbatimin e masës së paraburgimit në krahasim me vitin e kaluar është e dyfishtë, gjegjësisht kemi rënie prej 50% në krahasim me vitin e kaluar.

Trendi i rënies së zbatimit të masës së paraburgimit dhe i rritjes së zbatimit të masave më të lehta për sigurimin e pranisë do të ishte epilogu i dëshiruar i të gjitha analizave tona të deritanishme. Gjegjësisht, zbatimi i të gjitha masave për sigurimin e pranisë në 18% të seancave të vëzhguara, ndërsa zbatimi i masës së paraburgimit në 6% të rasteve të vëzhguara (grafiku nr.10). Pikërisht ky trend i përmbush përfundimet dhe rekomandimet disavjeçare të dhëna në analizat tona për zbatimin më të kufizuar të masës së paraburgimit, ndërsa zbatimin më të shpeshtë të masave më të lehta për sigurimin e pranisë. Përfundimi i këtillë, nëse nuk bëhet fjalë për mostër të rastësishme, por për mostër reprezentative, nga aspekti statistikor në krahasim me të dhënat nga vendet e tjera të BE-së do ta vendoste vendin⁸ në listën e shteteve të dëshiruara sa i përket respektimit të së drejtës së të akuzuarit për t'u mbrojtur në liri gjatë shqyrtimit kryesor.

7 Shih: Kallajxhiev G., Llazhëtiq G., Nedellkova L., Denkovska M., Trombeva M., Vitllarov T., Jankullovska P., Kadiev D., Koment i Ligjit për procedurën penale, OSBE, Shkup, 2018, fq. 334 e të ngjashme.

8 Shih: van Kalmthout, AM, Knapen, MM dhe Morgenstern, C., ed. Pre-trial Detention in the European Union, WLP, 2009, fq. 55-56.

Në sa raste është përcaktuar paraburgimi?



Grafiku nr.10

Megjithatë, edhe përkundër treguesve pozitivë statistikorë, nuk mund të jemi plotësisht të kënaqur me rezultatet e fituara. Kjo për faktin se në vetëm njërin nga rastet e analizuara është zbatuar masa e garancisë, si dhe për faktin se në një farë mënyre kemi favorizim të njëres nga masat parandaluese. Kjo do të thotë se nga gjithsej 43 masa të zbatuara më të lehta për sigurimin e pranisë, 26 janë masa parandaluese, nga të cilat me 13 raste dominon masa e marrjes së pasaportës, dhe pastaj vijnë nga 3 raste të zbatimit të masës së ndalimit për të mbajtur kontakte me persona të caktuar, në nga 2 raste ndalim për largim nga vendi i banimit, si dhe obligim për t'iu paraqitur personit zyrtar, ndërsa për 6 raste nuk është theksuar se cilat masa parandaluese janë përcaktuar nga gjykata. Ose, thënë ndryshe, nga gjithsej 7 masa parandaluese që parashihen me ligj, gjykata zbaton vetëm 3. Kjo përsëri e gjeneron përfundimin nga viti i kaluar se gjykata nuk disponon me burime adekuate përmes të cilave në mënyrë efikase do ta realizonte zbatimin dhe kontrollin mbi zbatimin e këtyre masave më të lehta për sigurimin e pranisë së personave të akuzuar gjatë shqyrtimit kryesor.⁹

Mu për këtë arsye, konsiderojmë se është e përshtatshme ta përsërisim përfundimin dhe rekomandimin e vitit të kaluar¹⁰ për reformimin e Ligjit për shërbimin e provës, ku do të ofrohej mundësia që shërbimet e provës të kenë kompetencë të zgjeruar në drejtim të kontrollit dhe monitorimit të zbatimit efikas të masave më të lehta për sigurimin e pranisë, të cilat sa i përket mënyrës së realizimit në praktikë janë shumë të ngjashme me sanksionet alternative, për të cilat është paraparë të veprojnë shërbimet e provës. Për më tepër, në rast të pranimit të kësaj kompetence shtesë për shërbimet e provës, konsiderojmë se nevojitet që ato të përforcohen në mënyrë plotësuese duke e rritur numrin e tyre dhe duke i rritur mjetet financiare që do t'u ndaheshin për organizimin dhe zbatimin e kompetencave të tyre.

Duke i pasur parasysh argumentet e lartpërmendura, mund të konstatojmë se ato paraqiten si pengesë edhe gjatë zbatimit të masës së garancisë. Gjegjësisht, gjykata së pari nuk ka të dhëna të mjaftueshme për gjendjen financiare të personit të akuzuar, pasi për zbatimin e shpesh të kësaj mase, të dhënat financiare gjykata do të duhej t'i merrte sipas detyrës zyrtare nga prokuroria publike

⁹ Për rolin e shërbimeve të provës në zbatimin e masave më të lehta për sigurimin e pranisë, shih: Cesaro Gianluca, "Probation officers are key actors in reforming pre-trial detention and ensuring effective cross-border justice in the EU", gjendet në: <http://cep-probation.org/probation-officers-are-key-actors-in-reforming-pre-trial-detention-and-ensuring-effective-cross-border-justice-in-the-eu/>

¹⁰ Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analizë e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, op. cit., fq. 14

ose nga shërbimi i veçantë që është përgjegjës vetëm për zbatimin e këtyre hetimeve financiare ndaj personit të akuzuar dhe të dhëna për profilizimin e personalitetit të tij¹¹. Në këtë mënyrë, gjykata nuk do të varet nga propozimi i të akuzuarit, ku gjykata aspak nuk do të mund ta verifikojë dhe të jetë e sigurt se prona e propozuar si siguri a është garanci e mjaftueshme dhe adekuate se ai person nuk do të ikë ose nuk do ta përsërisë veprën.

Sa i përket zbatimit të masës së paraburgimit shtëpiak, i kënaqshëm është numri prej 14 rasteve në krahasim me vitin e kaluar, kur kjo masë nuk është përcaktuar asnjë herë. Megjithatë, edhe në këtë rast, konsiderojmë se më së paku që mund të thuhet për zbatimin e kësaj mase është se ajo është problematike në kushte të mos ekzistimit të kushteve ligjore të përcaktuara në mënyrë të qartë, e po ashtu ku nuk ekzistojnë shërbime të veçanta që do ta kontrollonin lëvizjen e personit të akuzuar në kushte të masës së përcaktuar për paraburgim shtëpiak. Mu për këtë arsye, mendojmë se duhet ta riafirmojmë përfundimin e vitit të kaluar mbi rieditim ligjor të kësaj mase në LPP, ku kjo masë fillimisht do të zbatohet në rastet kur do të bëhet fjalë për persona që kanë nevojë reale për vuajtjen e paraburgimit në kushte shtëpiake, në përputhje me rrethanat nga Kodit Penal (KP) në lidhje me sanksionin alternativ të arrestit shtëpiak, gjegjësisht, në qoftë se bëhet fjalë për person që është i sëmurë kronik, në moshë dhe i dobët, ose shtatzënë.

Për më tepër, konsiderojmë se nëpërmjet ndërhyrjes në dispozitat e Ligjit për shërbimin e provës dhe në LPP, ku në mënyrë adekuate do të parashiheshin dispozitat për paraburgim shtëpiak me mbikëqyrje elektronike, do të mund të rritej dhe të përmirësohej zbatimi i kësaj mase. Në këtë mënyrë, masat e paraburgimit shtëpiak dhe paraburgimit shtëpiak me mbikëqyrje elektronike do të futeshin nën kompetencën e zyrtarëve të shërbimit të provës, me ç'rast gjykatat do të ishin të sigurta në besueshmërinë dhe arsyeshmërinë e zbatimit të këtyre masave, do të mbrohej në masë të madhe e drejta e lirisë së lëvizjes së personave të akuzuar dhe në fund, zbatimi i këtyre masave nëpërmjet shërbimeve të provës do të mund ta hapte rrugën për zbatimin e saj dhe për rastet kur bëhet fjalë për të akuzuarit e tjerë, prania e të cilëve do të sigurohej nëpërmjet këtyre masave më të lehta.¹² Pikërisht përmes këtyre ndërhyrjeve ligjore do të eliminohej praktika e deritanishme e arratisjes së personave që janë në paraburgim shtëpiak¹³, ose prania e tyre do të sigurohej me një masë më të lehtë për sigurimin e pranisë. Konsiderojmë se nëse kontrolli i zbatimit të masave më të lehta për sigurimin e pranisë bartet në një shërbim funksional, i cili në të ardhmen mund të jetë shërbimi i provës ose ndonjë njësi e veçantë në kuadër të MPB-së, gjykata do të ishte shumë më e sigurt në zgjedhjen e saj që praninë e personave të akuzuar ta sigurojë me masa më të lehta për sigurimin e pranisë, si dhe përmes vlerësimit të pranuar të individualizuar të rrezikut nga shërbimet profesionale, do të mund të përcaktonte kombinimin më adekuat të masave më të lehta për sigurimin e pranisë që do të kishin efekt më të madh në kushte të kufizimit më të vogël të lirisë së lëvizjes.

11 Për shembuj të këtillë nga kompetenca e Shërbimeve të provës, për shembull, në Holandë ose në Francë, shih: Van Kalmthout, AM, Durnesku, L., Probata në Evropë, fq. 23-30; ose në SHBA, Federal Pretrial Risk Assessment Instrument, User's Guide, Office for Probation and Pretrial Services, 2016. Gjetet në: <https://www.ncjrs.gov/>


12 Në këtë rast, shërbimet e provës do të vlerësonin se a do të ishin këto masa të përshtatshme dhe adekuate për personalitetin e personit të akuzuar, si dhe a do të paraqitej i padituri rregullisht para gjykatës gjatë procedurës penale me zbatimin e tyre, e me këtë edhe a do të paraqiste mbajtja e tij në liri ndonjë rrezik qoftë për zhvillimin e procedurës penale, ose për sigurinë e personave të tjerë apo të publikut të gjerë. Për vlerësimin e faktorëve të rrezikut shih: Hucklesby Anthea and Marshall Emma, Tackling Offending on Bail, The Howard Journal, Vol. 39, No.2. May, 2000, fq. 150-170.

13 Shih rastin e fundit nga seria e ikjes së personave të dënuar pas realizimit të të ashtuquajturave procedura penale të "profilit të lartë", me ç'rast këtyre personave u ishin përcaktuar masa më të lehta për sigurimin e pranisë, gjegjësisht ikja e personit të dënuar Nikolla Vojminovski, i cili ishte dënuar me 13 vjet burg me aktgjykim që nuk ishte i plotfuqishëm. Shih: <https://www.mkd.mk/makedonija/sudstvo/izbegal-nikola-vojminovski-osuden-za-obidot-za-ubistvo-na-sela>

Për fat të keq, mbetet të presim ndryshime plotësuese në LPP në aspekt të saktësisimit të mbikëqyrjes elektronike si masë e veçantë për sigurimin e pranisë së të akuzuarit gjatë procedurës penale ose futjes së disa masave më moderne për sigurimin e pranisë, e të cilat janë të njohura në të drejtën krahasuese. Në këtë drejtim janë edhe rekomandimet për reformën e Ligjit për shërbimin e provës dhe të gjithë shërbimit të provës, me çka do të krijohet një klimë pozitive për zbatimin më të shpeshtë dhe më të përshtatshëm të masave më të lehta për sigurimin e pranisë së të akuzuarve në procedurat penale.

Një aspekt të veçantë të vlerësimit të drejtësisë së zbatimit të paraburgimit si masë më e rëndë për sigurimin e pranisë së të akuzuarit, vëzhguesit e Koalicionit zbuluan përmes pranisë së avokatit mbrojtës gjatë seancave kur të akuzuarit i ishte përcaktuar paraburgim. Në fakt, për dallim nga viti i kaluar, kur të akuzuarit të cilit i është shqiptuar paraburgim, seanca janë mbajtur në mungesë të mbrojtësit të tij në 9 raste, këtë vit ky numër është zvogëluar në vetëm një rast (grafiku nr.11).

A ka i akuzuari mbrojtës në shqyrtime kur i është përcaktuar paraburgim?



Grafiku nr.11

Kjo përqindje është për t'u përhëndetur dhe jep përshtypjen se mbrojtësit dhe gjykata janë korrigjuar në lidhje me respektimin e kalendarëve të tyre të ndërsjellë, edhe atë në favor të së drejtës për mbrojtje efektive të të akuzuarit në kushte kur ai gjendet në paraburgim.¹⁴ Megjithatë, edhe përkundër faktit se bëhet fjalë vetëm për një rast të zbuluar, nuk ka vend për triumfalizëm për arsye të thjeshtë se mund të konstatojmë se kjo praktikë e padëshirueshme e mbajtjes së seancave pa praninë e avokatit mbrojtës së të akuzuarit në kushte kur është përcaktuar paraburgim ende është e pranishme në gjykatat vendase, edhe përkundër faktit se bëhet fjalë për raste që janë në kundërshtim me LPP-në.

14 Për të drejtën për mbrojtje më efektive shih më shumë në: Kallajxhiev G., "Mbrojtja efektive në procedurat penale në R.M.", FSHM, Shkup, 2014.

Raporti i të akuzuarve me avokat mbrojtës kur është përcaktuar paraburgim




Grafiku nr.12

Për më tepër, mendojmë se edhe gjatë analizës së raportit të rasteve kur i akuzuari ka mbrojtës dhe kur është përcaktuar paraburgimi, ndërsa mbrojtësi nuk është i pranishëm në seancë, përkundër faktit se bëhet fjalë për një përqindje relativisht të vogël prej vetëm 3%, megjithatë mendojmë se një praktikë e tillë është e padëshirueshme dhe ndikon në mbrojtjen efikase të të akuzuarit që është në paraburgim. Në fakt, duke pasur parasysh kompleksitetin e shqyrtimit kryesor në pajtim me dispozitat e LPP-së, e sidomos faktin se bëhet fjalë për person të akuzuar që gjendet në paraburgim, konsiderojmë se LPP-ja edhe në këtë pjesë do të duhej të pësojë ndryshime me qëllim që prania e mbrojtësit të të akuzuarit të sigurohet gjatë gjithë gjykimit dhe në të gjitha seancat, e jo vetëm në seancat kur përcaktohet masa e paraburgimit (grafiku nr.12).

■ FJALIMET HYRËSE

Fjalimet hyrëse, praktikisht, janë pjesa fillestare e shqyrtimit kryesor në gjykatë. Përmes tyre, palëve u jepet mundësia t'i paraqesin faktet vendimtare të cilat kanë për qëllim t'i dëshmojnë, t'i shpallin provat që do t'i nxjerrin, si dhe t'i përcaktojnë çështjet që do të jenë temë e shqyrtimit. Ligji për procedurë penale te ne bën dallim ndërmjet kompetencave për veprim të gjykatës, si dhe zbatimit të këtij instituti në procedurë të rregullt ose të shkurtuar. Kur bëhet fjalë për procedurë të rregullt, parimi i mësipërm i futjes së fjalimit hyrës është rregull, me atë që mbrojtja gjithmonë ka të drejtë të mos mbajë fjalim hyrës, por, kur bëhet fjalë për procedurë të shkurtuar, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për vepra penale për të cilat është paraparë dënim me burg deri në 5 vjet, fjalimet hyrëse të përfaqësuesve të aktakuzës shndërrohen në prezantim të përmbajtjes së aktakuzës. Në këtë rast, ligji e përjashton mbrojtjen në aspekt të ofrimit të këndvështrimit të tyre kur paraqiten faktet vendimtare që janë në dobi të saj.

Duke marrë parasysh statistikën e lartpërmendura të përqindjes së madhe të procedurave të shkurtuara që u vëzhguan gjatë vitit të kaluar, e qartë është edhe përqindja e lartë e paraqitjes së përmbajtjes në propozim-akuzën (grafiku nr.13) kundrejt fjalimeve të mbajtura hyrëse.



Grafiku nr.13

Fakt i habitshëm është ajo se mbrojtësit janë duke e lënë praktikën e viteve të kaluara për mbajtjen e fjalimeve hyrëse në procedurë të shkurtuar. Në fakt, ndonëse fjalimet hyrëse nuk janë ligjërish të detyrueshme në procedurën e shkurtuar, deri tani ato shpesh përdoren edhe nga ana e mbrojtësve, por këtë vit nuk kemi regjistruar asnjë rast të vetëm të mbajtjes së fjalimeve hyrëse nga ana e mbrojtësve në procedurë të shkurtuar. Përkundrazi, është regjistruar paraqitja e përmbajtjes së propozim-akuzës në 55 shqyrtime, por jo edhe mbajtja e fjalimit hyrës nga mbrojtësit siç ishte rasti, për shembull, në vitin e kaluar - 14 fjalime hyrëse të mbrojtësve dhe 6 të të akuzuarve.

Përveç kësaj, imponohet edhe problemi i teknikës ende të papërvetësuar të mbajtjes së fjalimeve hyrëse në mesin e prokurorëve, për arsye se vëzhguesit kanë konstatuar se në 32% të shqyrtimeve, fjalimi hyrës është shndërruar në lexim të aktakuzës, e jo në mbajtje të një fjalimi thelbësor hyrës, në përputhje me rregullat për mbajtjen e tij.


Në kundërshtim me atë që e parasheh vetë LPP-ja, se në fjalimin hyrës palët nuk duhet ta paraqesin përmbajtjen e provave për arsye se kjo është paraparë në pjesën e mëtejshme të shqyrtimit kryesor përmes nxjerrjes së drejtpërdrejtë të provave para gjykatësit, gjegjësisht, që këshilli të njihet me to, te ne ende e vërejmë praktikën e paraqitjes së fakteve në lidhje me provat, edhe atë në 30% të shqyrtimeve të vëzhguara. Në këtë rast, duhet theksuar se kjo nuk vlen vetëm për prokurorinë, por edhe për mbrojtjen, edhe atë në përqindje identike të shqyrtimeve. Gjithashtu, ligji parasheh edhe atë se palët nuk duhet të paraqesin fakte për dënimin e mëparshëm të të akuzuarit, sepse këtë do të jenë në gjendje ta bëjnë në shqyrtimin kryesor duke paraqitur prova adekuate, por edhe këtu kemi një shmangie, thënë të vërtetën, vetëm në një rast edhe atë nga një prokuror publik.

Pas mbajtjes së fjalimit hyrës nga ana e përfaqësuesit të aktakuzës, gjykata është e detyruar ta pyesë të akuzuarin se a e ka kuptuar aktakuzën dhe a e ka kuptuar se për çfarë akuzohet. Për kryetarin e këshillit, gjegjësisht gjykatësin, ky obligim është i detyrueshëm, pavarësisht nga fakti se i akuzuari a ka mbrojtës ose jo, dhe a është palë që ka ose nuk ka njohuri nga fusha konkrete. Në qoftë se, për çfarëdo arsye, i akuzuari deklaron se nuk e ka kuptuar aktakuzën, gjykata është e detyruar, në mënyrën më të thjeshtë të mundshme, t'ia qartësojë atë, gjegjësisht t'ia paraqesë përmbajtjen e aktakuzës.

Nga të dhënat që vëzhguesit i kanë mbledhur në gjykata, mund të konstatojmë se gjykatësit në masë të madhe i zbatojnë dispozitat e parapara ligjore në lidhje me këto çështje. Megjithatë, ekzistojnë përjashtime të regjistruara, si për shembull fakti se në 4% të procedurave, i akuzuari nuk është pyetur se e ka kuptuar se për çfarë akuzohet (siç mund të shihet nga grafiku nr.14), si dhe atë


se, madje edhe atëherë kur i akuzuari ka deklaruar se nuk kupton, gjykata vetëm në 86% të lëndëve ia ka sqaruar këtë të akuzuarit. Është e papranueshme që gjykata të bëjë lëshim në një përqindje aq të madhe, 14% (siç mund të shihet nga grafiku nr.15) të lëndëve në të cilat i akuzuari ka deklaruar se nuk e kupton se për çfarë akuzohet, veçanërisht në fazën e procedurës kur ai ka mundësi pasi ta kuptojë akuzën ndaj tij ta pranojë edhe fajin, gjegjësisht të deklarohet se a është fajtor ose jo.

A u pyet i akuzuari nga ana e gjykatës se a kupton se për çfarë akuzohet



Grafiku nr.14


Nëse i akuzuari nuk e ka kuptuar, a i sqaroi gjykata se për cilën veprë penale akuzohet



Grafiku nr.15

■ KËSHILLA PËR TË DREJTAT E TË AKUZUARIT

Ligj për procedurë penale parasheh që çdo i akuzuar, para çdo marrjeje në pyetje, detyrimisht të informohet dhe të këshillohet se për çka akuzohet, se nuk është i detyruar ta paraqesë mbrojtjen e tij e as t'u përgjigjet pyetjeve të parashtuara, se ka të drejtë për avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së tij, të paraqesë fakte dhe prova që janë në favor të tij, si dhe të deklarohet për veprën për të cilën ngarkohet, për të drejtën për t'i shikuar shkresat dhe t'i shikojë sendet që janë konfiskuar, të drejtën për përkthyes, gjegjësisht interpretues, për të drejtën për kontroll nga mjeku gjatë nevojës për trajtim mjekësor ose për shkak të përcaktimit të tejkalimeve eventuale policore, si dhe të informohet për të drejtën për të arritur marrëveshje për fajin me PP-në (neni 206). Për rëndësinë e këshillave për të drejtat flet edhe fakti se ligjvënësi ka paraparë, nëse gjykata vepron në kundërshtim me dispozitat që parashohin këshillim për të drejtat, deklarata e të akuzuarit të mos mund të përdoret gjatë procedurës gjyqësore. Mu për këtë arsye, temë e kësaj analize ishin edhe çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e personave të akuzuar. Kështu, pyetësori që u përdor për nevojat e kësaj analize përfshin një pjesë të këtyre të drejtave, apo më saktë thënë, ato më themeloret për të cilat duhet të këshillohet çdo i akuzuar. Gjatë analizimit të të dhënave që u mbledhën nga ana e vëzhguesve mund të vërejmë (grafiku nr.16) se e drejta me të cilën më shpesh janë këshilluar të akuzuarit, në fakt është e drejta që ai të japë deklaratë, pastaj të drejtën për të paraqitur prova në mbrojtje të tij, si dhe të drejtën për të heshtur, e menjëherë pas kësaj edhe të drejtën për vërejtje ose mbrojtës. E drejta për të cilën janë vërejtur më së paku këshillime është e drejta për përkthyes.




Grafiku nr.16

Komenti i fundit i dhënë në lidhje me LPP-në në arsyetimin për këtë çështje gjithashtu parasheh edhe se "Çdo këshillë që është përmendur në paragrafin 1 të nenit 206 të LPP-së, të akuzuarit duhet t'i tregohet veç e veç dhe atij duhet t'i jepet mundësia të deklarohet veç e veç për secilën të drejtë nga paragrafi 1 i këtij neni"¹⁵. Nëse ky interpretim i autorëve do të ishte pranuar nga gjyqtarët që e zbatojnë ligjin, grafiku nr.12 do t'i kishte përmbyshur me 100 për qind të gjitha kategoritë e të drejtave të cilat janë të parapara, por meqenëse nuk është kështu, mbetet që kjo çështje të trajtohet nga ata që punojnë në praktikë me qëllim që të përmirësohet gjendja në lidhje me këtë çështje.

Por nëse e analizojmë pak më thellë këtë fushë, do të mund të konstatojmë edhe se atë që e ka paraparë ligjvënësi dhe atë që e theksojnë autorët e komentit të LPP-së, se të drejtat e të akuzuarve jo vetëm që duhet të numërohen, por ato duhet edhe të shpjegohen në mënyrë të kuptueshme për të akuzuarin, përsëri ata që punojnë në praktikë i shmangen që ta zbatojnë në tërësi. Në fakt, nga paraqitja grafike nr.17 mund të shihet raporti i përqindjes në lidhje me atë se a i janë shpjeguar të akuzuarit të drejtat në mënyrë të kuptueshme ose jo, gjegjësisht si i janë shpjeguar - grafiku nr.18. Nga këto paraqitje grafike mund të konstatojmë se në 25% të shqyrtimeve, vëzhguesit kanë konstatuar se të akuzuarve nuk u janë shpjeguar të drejtat në mënyrë që ata t'i kuptojnë ato, gjegjësisht vetëm në 23% të shqyrtimeve ato janë shpjeguar në detaje, në 54% vetëm janë përmendur, ndërsa në 23% nuk janë shpjeguar fare.


15 Kallajxhiev G., Llazhetiq G., Nedellkova L., Denkovska M., Trombeva M., Vitllarov T., Jankullovska P., Kadiev D., Koment i Ligjit për procedurën penale, OSBE, Shkup, 2018

A i u shpjeguan të akuzuarit të drejtat në mënyrë të kuptueshme (viti 2018)



Grafiku nr.17


Në çfarë mënyre u shpjeguan të drejtat (viti 2018)



Grafiku nr.18


Në krahasim me analizën e vitit të kaluar të gjendjes lidhur me shpjegimin e të drejtave të të akuzuarve, vërejmë një përqendrim të gjendjes. Në fakt, grafiku nr.19 i dhënë më poshtë tregon një raport përqindjeje prej 93% kundrejt 7% në favor të shpjegimit të kuptueshëm të të drejtave në vitin 2017, që është rezultat më i mirë në krahasim me këtë vit, kur ky raport është 75% kundrejt 25%, që tregon se ka një rritje të madhe të kësaj përqindjeje. E njëjta gjë ndodh edhe kur bëhet fjalë për mënyrën e shpjegimit të të drejtave. Nëse në vitin 2017 kemi pasur 6% të drejta të pashpjeguara (grafiku nr.20), këtë vit kemi 23%, ndërsa e njëjta gjë ndodh edhe me përqindjen për shpjegimin e detajuar, vetëm se ky rast shkon me dinamikë të zhdrejtë, dhe kështu, përkundër rritjes së të drejtave të pashpjeguara përballemi me një situatë të përqindjes së zvogëluar të të drejtave të shpjeguara detajisht, edhe atë prej 44% në 23%.

Shpjegimi i të drejtave të të akuzuarit në mënyrë të kuptueshme për të (viti 2017)



Grafiku nr.19

Si iu shpjeguan të drejtat të akuzuarit (viti 2017)?



Grafiku nr.20


ZBATIMI I PRANIMIT TË FAJIT

Momenti tradicional interesant i procesit zbatimi i pranimit të fajit të personave të akuzuar si mënyrë për përshpejtimin e procedurës penale është pjesë e pandashme edhe e analizës së këtij viti. Në fakt duke pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për mjet shumë efikas për përshpejtimin e kohëzgjatjes

së procedurave penale¹⁶ e cila në të njëjtën kohë është edhe shumë e diskutueshme për shkak të faktit se bëhet fjalë për përshpejtimin e pjesës më të rëndësishme të procedurës penale - shqyrtimit kryesor, ku më së shumti vijnë në shprehje garancitë e procesit të personit të akuzuar, konsiderojmë se është e pëlqyeshme të kontrollohet se a janë trajtuar këtë vit në mënyrë adekuate rekomandimet e vitit të kaluar. Në fakt, a kemi ndonjë lëvizje pozitive në lidhje me zbatimin e LPP-së dhe respektimin e të drejtave të personave të akuzuar gjatë shqyrtimit kryesor brenda periudhës së analizës së këtij viti.

Duke marrë parasysh faktin se sivjet kemi një numër më të madh të shqyrtimeve dhe të lëndëve të analizuara, mund të konstatojmë se ka rënie të numrit të pranimin të fajit nga ana e personave të akuzuar gjatë shqyrtimit kryesor. Në fakt, për dallim nga viti i kaluar kur të akuzuarit kanë qenë të gatshëm ta pranojnë fajin në 40 seanca nga gjithsej 312 seanca, këtë vit, gatishmëri të këtillë të akuzuarit kanë shprehur vetëm në 26 seanca nga gjithsej 415 seanca¹⁷. Kjo do të thotë se kemi një rënie serioze në pranimin e fajit gjatë shqyrtimit kryesor para gjykatave vendase. Kështu, nëse vitin e kaluar kemi pasur një përqindje prej pak më shumë se 10% të seancave ku është pranuar faji, këtë vit kemi një rënie serioze në 6% të numrit të përgjithshëm të shqyrtimeve, ose një rënie prej pothuajse 40%.

Numri i shqyrtimeve me pranimin e fajit në krahasim me numrin e shqyrtimeve të vëzhguara sipas qyteteve



Grafiku nr.21

Në shikim të parë, vërehet se rënie më të madhe në pranimin e fajit ka para Gjykatës Themelore Shkup 1, ku vëzhguesit tanë arritën të vërejnë pranim të fajit nga persona e akuzuar në vetëm dy raste, që nga 108 seancat e vëzhguara këtë vit në Shkup, është përqindje seriozisht e ulët, veçanërisht nëse bëjmë krahasim me vitin e kaluar kur kishim 129 seanca të vëzhguara, në 7% të të cilave është bërë pranimi i fajit. Pra, kemi zvogëlim të numrit të seancave me pranim të fajit prej 7% në pothuajse 2%, që paraqet një rënie prej 3.5 herë. Trendi i rënies së numrit të seancave në të cilat të akuzuarit e kanë pranuar fajin është i dukshëm edhe në të gjitha gjykatat e tjera të vëzhguara,

16 Procedurë që njihet në shumë legjislacione nëpër botë, si dhe nga ana e Këshillit të Evropës përmes Rekomandimit Nr. (87) 18, të Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare lidhur me Thjeshtësimin e Drejtësisë Penale. Shih edhe: Buzharovska G., Misoski B., "Plea Bargaining under the CPC", në Simplified Forms of Procedures in Criminal Matters – Regional Criminal Procedure Legislation and Experiences in Application, Ivan Jovanovic and Mirosljub Stanisavljevic eds., OSCE Mission to Serbia, 2013

17 Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analizë e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, op. cit., fq. 22-23.

dhe krahasuar me vitet e mëparshme, zvogëlimet më drastike janë në gjykatat themelore Manastir, Shkup dhe Veles (grafiku nr.21).

Ky trend i zvogëlimit të numrit të seancave në të cilat të akuzuarit e kanë pranuar fajin përkon edhe me të dhënat zyrtare të marra nga gjykatat në vend¹⁸, prej ku mund të nxirret përfundimi se ka pengesa të qarta në zbatimin e pranimit të fajit nga të akuzuarit si mënyrë për përshpejtimin e efikasitetit të procedurës penale.

Arsyet për këtë rënie serioze në pranimit e fajit gjatë shqyrtimit kryesor mund të jenë si rezultat i disa treguesve. Treguesi i parë është politika e ulët ndëshkuese e gjykatave, si faktori më serioz në vendimin e të akuzuarve për pranimin ose mospranimin e fajit gjatë shqyrtimit kryesor. Treguesi i dytë është përgatitja e prokurorisë publike me prova për t'i mbështetur akuzat. Treguesi i tretë lidhet me besimin e publikut ndaj gjyqësisë. Tregues tjetër mund të gjendet në faktin se mbrojtësit nuk kanë interes t'i përfaqësojnë klientët në kushte kur ata e kanë pranuar fajin, për shkak të tarifave më të ulëta të avokatëve. Tregues i mundshëm mund të ishte edhe roli i gjykatës në procedurën për vlerësimin e pranimit të fajit¹⁹, si dhe gatishmëria e gjykatës për të vendosur edhe për elementet plotësuese, si kompensimin për dëmet ose zbatimin e konfiskimit.

Megjithatë, për ndikimin e vërtetë të të gjithë këtyre treguesve në vendimin e të akuzuarve për ta pranuar fajin dhe të gjykatës për ta pranuar këtë pranim të fajit dhe për ta përcaktuar sanksionin adekuat, duhet të bëhet një hulumtim i mëtejshëm dhe më i thelluar, sepse të dhënat e marra nga vëzhguesit tanë sinjalizojnë një problem serioz në procedurën penale që mund të ketë pasoja afatgjate në aspekt të efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale, që do të krijonte problem në perceptimin e qytetarëve për sistemin e ndarjes së drejtësisë, si një nga garantuesit e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në këtë aspekt, kjo mund të interpretohet si rënie e besimit ndaj gjykatës, gjegjësisht mospasje e interesit për pranimin e fajit, e me këtë edhe për përshpejtim të procedurës penale, për shkak të paqartësisë së procedurës penale, e cila perceptohet si e ngadalshme dhe joefikase, e me këtë edhe se ka mundësi që ndëshkimi për veprimin e bërë fare të mos ndodhë. Ose, momenti i dytë është se qytetarët nuk kanë frikë nga institucionet hetuese, ndërsa kanë besim më të madh te gjykata dhe nuk kanë frikë të mos e pranojnë fajin, me qëndrimin se në kushte të mospranimit të fajit pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, mund të kalojnë më mirë. Gjegjësisht, se qytetarët janë më të gatshëm ta shfrytëzojnë ditën e tyre në gjykatë dhe në shqyrtimin e drejtpërdrejtë kryesor t'i përballin argumentet e tyre me argumentet e prokurorit publik, se sa në një farë mënyre t'ia "lehtësojnë" punën prokurorit publik dhe të pranojnë se e kanë kryer veprën penale.

Sidoqoftë, për të gjitha këto dilema, sado të pranueshme ose të papranueshme të jenë, nevojitet një analizë më e thelluar. Fakti i vetëm i njohur deri tani nga faktorët e lartpërmendur është heqja e Ligjit për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal, që ndoshta mund të ketë qenë vendimtar për të akuzuarit, si nxitje për ta pranuar fajin. Ose, thënë ndryshe, përmes këtij ligji të akuzuarit kishin mundësi të llogarisin saktësisht se sa do të ishte e ashtuquajtura mëshira e sistemit nga ana e gjyqtarëve në kushte të fajit të pranuar. Ndoshta, pikërisht ky argument është njëra nga arsyet më të rëndësishme për rënien e zbatimit të pranimit të fajit gjatë shqyrtimit kryesor si mënyrë për përshpejtimin e procedurave penale²⁰. Që do të thotë se, në kushte të paqartësisë së sanksionit,

18 Shih të dhënat e Gjykatës Themelore Shkup I, në pjesën e P-PP (penale - propozim-marrëveshje) që gjenden në: <https://bit.ly/31M36g4>

19 Shih: Misoski B., Ilikj Dimoski D., Judges' Role in the Evaluation of the Defendant's Plea within the Sentence Bargaining Procedure, Journal of the Faculty of Security, Skopje, University St. Klement of Ohrid, Bitola, 2016; ose Alschuler, Albert W., The Trial Judge's Role in Plea Bargaining, Part I, Columbia Law Review, Vol. 76, No. 7, Nov., 1976

20 Përkundër faktit se argumentet për heqjen e Ligjit për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal ishin të shumta dhe të qëndrueshme, fillimisht si një ligj i keq dhe jociësor, megjithatë ka përkrahës të shumtë për zbatimin më të shpeshtë të pranimit të fajit, me një zgjidhje ku në sistemin e drejtësisë penale do të ekzistonte një lloj udhëzimi apo rregulloreje për

paqartësisë për shqiptimin e shpejtë të sanksionit, si dhe politikës së ulët ndëshkuese nga ana e gjykatave, të gjitha këto i demotivojnë të akuzuarit ta pranojnë fajin si mënyrë për zgjidhjen e shpejtë të rasteve penale.

Pasojat e këtij fenomeni janë shumë të gjera në aspekt të shpenzimit të burimeve të kufizuara gjyqësore, e me këtë edhe në zvogëlimin e kapacitetit jo vetëm të gjykatës, por edhe të të gjitha subjekteve në procedurën penale, që burimet e tyre t'i përqendrojnë në zbulimin, ndjekjen dhe dënimin e autorëve të veprave më të rënda dhe më të ndërlikuara penale. Mu për këtë arsye, konsiderojmë se është e nevojshme të bëhet një analizë e gjerë e arsyeve për këtë fenomen, e cila do të ishte bazë për një reagim adekuat në të drejtën pozitive, me qëllim të ringjalljes së këtij mjeti me të vërtetë efikas për përshpejtimin e procedurave penale.


Sa i përket llojit të veprave penale, përsëri mund ta japim përfundimin e vitit të kaluar se, më së shpeshti, pranimi i fajit bëhet për vepra penale tradicionale, gjegjësisht më shpesh kjo bëhet për veprat e pronës dhe veprat e dhunës, me çrast për dallim nga viti i kaluar dhe në përputhje me vitin paraprak, në skenë kthehen edhe veprat më të lehta penale kundër jetës dhe trupit – lëndimi trupor sipas nenit 130 të Kodit Penal dhe lëndimi i rëndë trupor sipas nenit 131 të Kodit Penal. Njësoj sikurse edhe vitin e kaluar, nga të dhënat e mbledhura del se të akuzuarit për vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor janë më pak të interesuar ta pranojnë fajin për veprimet e tyre.

Duke i marrë parasysh të dhënat statistikore për vëllimin dhe dinamikën e kriminalitetit, në shikim të parë mund të konstatojmë se pranimi i fajit lidhet me llojin e veprave penale, e sidomos me veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, ku të paditurit sikur duan që lënda e tyre të gjykohet publikisht, e jo të përfundojë shpejt, me efikasitet dhe vetëm në një seancë (grafiku nr.22).

Nga numri i pranimit të fajit në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve dhe në raport me rëndësinë dhe llojin e veprave penale për të cilat zbatohet, mund të nxirret përfundimi se të akuzuarit, në parim, zgjedhin të shkojnë në gjyq. Ky vendim i tyre mund të bazohet ose në argumentet se do të marrin një sanksion më të lehtë, ose për shkak të faktit se prokurori publik nuk ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave do të pretendonte për një dënim më të rëndë duke e dëshmuar fajin e të akuzuarit ose për faktin se ata konsiderojnë se presioni i publikut mbi organet e hetuesisë dhe gjykatën u jep siguri më të madhe se do të zhvillohet një gjykim i drejtë. Megjithatë, duke pasur parasysh numrin e ulët të pranimit të fajit, si dhe për shkak të mungesës së qëndrimeve të të akuzuarve, këto përfundime duhet të merren me rezervë, deri sa të bëhet vlerësimi plotësues i tyre në mënyrë empirike.

përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksioneve, gjë që do ta bënte sanksionin më të qartë për personat e akuzuar. Në këtë drejtim, shumë interesant është shembulli i Anglisë dhe i Italisë për skicimin e llojit dhe lartësisë së sanksioneve penale. Veçanërisht në kushte të një sistemi efikas të TIK-ut, i cili do të mund të bëjë kërkime të brendshme sipas disa ndryshoreve të llojit dhe lartësisë së aktgjyqimeve të shpallura. Shih M. McConville, "Plea Bargaining: Ethics and Politics", Journal of Law and Society, Vol. 25, no. 4, 1998, fq. 570 dhe të tjerët; ose Sprack John, A Practical Approach to Criminal Procedure, Oxford University Press, 10-th Edition 2005, fq. 92. si dhe kritikata te: Buzharovska G., Tupançeski N., Sentencing Guidelines, "Paradoksi i legjislacionit maqedonas," Pravnik, nr.238, nëntor, 2015.

Numri i pranimit të fajit sipas veprave penale



Grafiku nr.22


Përfundimi i mësipërm mund të mbështetet në mënyrë plotësuere nga të dhënat e marra nga vëzhguesit, sipas të cilave pranimi i fajit më së shumti është bërë në procedurën e shkurtuar (grafiku nr.7). Gjegjësisht, nga gjithsej 26 pranime të fajit, 24 janë bërë në procedurat e shkurtuara, ndërsa vetëm 2 janë bërë në procedurë të rregullt.

Sipas këtyre të dhënave, e në korrelacion edhe me të dhënat e vitit të kaluar, kur nga 40 pranime të fajit vetëm 3 u bënë në procedurë të rregullt, mund të konstatojmë se pranimi i fajit është i lidhur në mënyrë të veçantë me atë se sa e rëndë është vepra penale ose me dënimin e pritur, gjegjësisht se të akuzuarit janë të prirur për ta pranuar fajin vetëm për veprat më të lehta penale, ndërsa për ato më të rëndat, duan ta kenë "ditën e tyre në gjykatë"²¹. Kjo praktikë përsëri mund të lidhet edhe me besimin ndaj gjykatës dhe punën e tyre. Në mënyrë të ngjashme, procedura për marrëveshjen për fajin dhe pranimi i fajit, si mënyra për përsheptimin e procedurës penale, e me këtë edhe si procedura me publicitet të zvogëluar në kushte kur qytetarët kanë besim të ulët në pavarësinë e gjykatës, me gjasë nuk janë metodat më të preferuara për përmbylljen e kontesteve nga e drejta penale.

Për këtë arsye, konsiderojmë se, me rritjen e besimi ndaj gjykatës, do të rritet edhe zbatimi i këtyre procedurave të shkurtuara, përveç qartësisë së dënimeve, gjykatat ndoshta do të duhet

²¹ Ose, thënë ndryshe, ka të ngjarë që qytetarët të mendojnë se garantuesi i vetëm dhe më i fortë i të drejtave të tyre nuk janë institucionet, por publiku, i cili, nga ana tjetër, është vetëdijuesur mjaft dhe reagon ndaj keqpërdorimeve të mundshme të të drejtave të të akuzuarve. Diçka që në afat të gjatë, gjithsesi është praktikë e dëshirueshme si reagim nga publiku i gjerë, që në të ardhmen do të kontribuonte për krijimin e institucioneve të përgjegjshme, gjë që po ashtu do ta rriste edhe besimin e qytetarëve në këto institucione.

të punojnë për të pasur transparencë edhe më të madhe duke i publikuar të dhënat për numrin e lëndëve të zgjidhura përmes pranimit të fajtit, si dhe duke i krahasuar dënimet e përcaktuara në procedurat e rregullta me ato në procedurat në të cilat është bërë pranimi i fajtit. Përmes fushatave të këtilla, do të zvogëlohej përshtypja se gjatë pranimit të fajtit bëhet fjalë për "arritje të ujdisë" me drejtësinë, gjegjësisht se bëhet fjalë për veprime që do të mund të ishin në dëm të drejtësisë. Në këtë drejtim, do të duhej të vihen në dispozicion të publikut të gjitha rregulloret që ekzistojnë në kuadër të Prokurorisë Publike, me të cilat rregullohet në mënyrë plotësuese roli i prokurorit publik në procedurën e marrëveshjes për fajin. Në këtë mënyrë, publiku do të kishte besim tek ky organ dhe do ta trajtonte atë si zbatues i paanshëm i drejtësisë, e jo si një prokuror publik hakmarrës, që do ta sanksionojë gatishmërinë e të akuzuarve për ta pranuar fajin, e me këtë eventualisht edhe të marrin sanksion më të lehtë nga gjykata, në një procedurë të shpejtë dhe efektive penale.



Grafiku nr.23


Me qëllim që të mbështeten tezat e mësipërme për besimin ndaj gjykatave, të shprehura përmes gatishmërisë së të akuzuarve për ta pranuar fajin, mund të analizohen edhe të dhënat për pranimin e fajtit, në rastet kur i akuzuari ka pasur avokat mbrojtës. Kështu, sipas të dhënave nga grafiku nr.23, mund të shohim se të akuzuarit janë të gatshëm ta pranojnë fajin në numër pothuajse identik, edhe kur kanë edhe kur nuk kanë avokat mbrojtës. Gjegjësisht, raporti është 13 pranime të fajtit në prani të mbrojtësit kundrejt 10 pranimeve të fajtit pa mbrojtës. Kjo do të thotë se të akuzuarit, në masë të madhe nuk e perceptojnë garancinë e mbrojtësit²² si vendimtare gjatë marrjes së vendimit të tyre se a do të pranojnë fajin ose jo. Ose, thënë ndryshe, ata mendojnë se, duke pasur parasysh rëndësinë e veprës penale, garanci e mjaftueshme për një vlerësim korrekt dhe të drejtë të pranimit të fajtit është gjykata. Një pasojë tjetër e mundshme është se të akuzuarit konsiderojnë se bëhet fjalë për vepër më të lehtë, prokurori publik ka prova të mjaftueshme dhe të forta, dhe për këtë arsye të akuzuarit nuk kanë interes për t'iu kundërvënë me argumente apo prova, që do të thotë se pajtohen me rezultatin përfundimtar, dhe për këtë arsye nuk konsiderojnë se prania e avokatit do të mund të bënte ndonjë ndryshim sa i përket rezultatit përfundimtar të procedurës penale. Në këtë rast, konsiderojmë se prania e avokatit mbrojtës gjatë pranimit të fajtit do të ndikonte në masë të madhe në krijimin e një

²²Shih: Alschuler, A., The Defense Attorney's Role in Plea Bargaining, University of Chicago, 1974, gjendet në: https://chicagounbound.uchicago.edu/cgi/viewcontent.cgi?referer=https://www.google.com/&httpsredir=1&article=1981&context=journal_articles

qëndrimi pozitiv ndaj zbatimit të procedurës për marrëveshje, me faktin se avokati mbrojtës do të paraqitet si një garantues plotësues përveç gjykatës, se të drejtat e të akuzuarit në kushte të fajit të pranuar do të mbrohen në mënyrë adekuate dhe të drejtë.

Mu për këtë arsye, e në korrelacion edhe me përfundimin e vitit të kaluar, konsiderojmë se është e nevojshme të korrigohet Ligji për procedurën penale ku do të përcaktohej prania e detyrueshme e avokatit mbrojtës kur do të bëhet pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit, pavarësisht nga pesha e veprës, për shkak se ky zbatim në një farë mënyre mund të ndikojë pozitivisht në perceptimin e publikut sa i përket drejtësisë së kësaj procedure, e me këtë edhe në rritjen e besimit në pavarësinë e gjykatës. Për më tepër, pasi që sipas parimeve të LPP-së lidhur me zhvillimin e shqyrtimit kryesor, e sidomos duke i pasur parasysh procedurat e ndërlikuara për nxjerrjen e provave, konsiderojmë se nuk ka nevojë aspak të bëhet dallimi midis procedurës së rregullt dhe asaj të shkurtuar. Në këtë mënyrë, konsiderojmë se do të eliminohej praktika që i akuzuari të mund ta bëjë pranimin e fajit në procedurë të shkurtuar pa praninë e avokatit mbrojtës, ndërsa gjatë procedurës së rregullt për pranimin e fajit do të ishte e domosdoshme prania e avokatit mbrojtës. Kështu, konsiderojmë se në lidhje me këtë procedurë dhe pasojat e pranimit të fajit, fare nuk ka rëndësi fakti se a bëhet fjalë për veprë penale për të cilën parashihet dënim me burg deri në 5 vjet ose dënim më i rëndë. Më në fund, duke marrë parasysh shpeshësinë e pranimit të fajit dhe peshën e veprave penale, si dhe praninë e avokatit mbrojtës, në përputhje me kushtet e tanishme, mund të shkojmë në drejtim krejtësisht të padëshiruar dhe të nxjerrim përfundim të gabuar se avokati është i tepërt në situatat kur i akuzuari është i gatshëm ta pranojë fajin.

Në këtë drejtim, në rastet kur i akuzuari ka pasur mbrojtës, nuk mund të konstatojmë se roli i tij ka qenë sa për sy e faqe. Gjegjësisht, nga 13 raste në vetëm një rast ose 8%, i akuzuari dhe avokati nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'u konsultuar në lidhje me pranimin e fajit, ndërsa në 12 raste, avokati mbrojtës ka pasur kohë dhe mundësi të mjaftueshme ta përgatisë mbrojtjen e tij dhe ta këshillojë klientin e tij në lidhje me pasojat nga pranimi i fajit (grafiku nr.24). Këto të dhëna, në krahasim me të dhënat e vitit të kaluar, kur në 9% të rasteve nuk ka pasur kohë dhe mundësi të mjaftueshme për konsultim ndërmjet të akuzuarit dhe avokatit të tij, gjenerojnë përfundimin se në këtë sferë nuk kemi përmirësim të situatës. Mu për këtë arsye, konsiderojmë se është e nevojshme të mbahen trajnime plotësuese për ta rritur vetëdijen e gjyqtarëve rreth nevojës dhe rolit të avokatit mbrojtës në këto procedura.




Grafiku nr.24

Në fund, dëshirojmë ta potencojmë faktin shumë problematik se në një rast nga procedura e rregullt, ku i akuzuari nuk ka pasur avokat mbrojtës (grafiku nr.23), por e ka pranuar fajin, kjo është pranuar nga gjykata. Jo vetëm që kjo procedurë është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, por

konsiderojmë se duke e lejuar këtë qasje anulohen të gjitha përfitimet e sistemit kundërshtues kurse ruhen të gjitha karakteristikat e procedurës penale inkuizitore, ku në mungesë të avokatit mbrojtës, i akuzuari e pranon fajin dhe merrret në pyetje vetëm nga prokurori dhe ndoshta edhe nga gjykata, që sipas përkufizimit është karakteristikë e parimeve inkuizitore për mbajtjen e shqyrtimit kryesor, e të cilat janë shumë të kritikuar. Në konfigurimin e këtyre, me të vërtetë, roli i të akuzuarit perceptohet si "dash kurban", që është në kundërshtim me arritjet bashkëkohore të doktrinës për gjykim të drejtë, që është karakteristikë e shoqërive demokratike. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë vetëm për një rast, mbetet shpresa se ndoshta bëhet fjalë për gabim dhe se është bërë lëshim, qoftë nga vëzhguesit ose nga gjykata kur është pranuar ky pranim i fajit.

Zbatimi i drejtë i garancive të procesit për pranimin e vetëdijshëm dhe vullnetar të fajit, gjegjësisht roli i gjykatës gjatë pranimin të fajit, është vlerësuar nëpërmjet disa pyetjeve nga ana e vëzhguesve tanë. Vërehet një tendencë në përafërsisht 81% të lëndëve kur të akuzuarit e kanë pranuar fajin, se gjyqtarët në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme u kanë shpjeguar se çfarë pranojnë, gjegjësisht ua kanë shpjeguar të gjitha tiparet e veprës penale (grafiku nr. 25)²³. Për fat të keq, edhe pse kemi përqendrim në krahasim me vitin e kaluar, kjo megjithatë nuk është aq drastike, gjegjësisht nga 87% në vitin e kaluar, këtë vit kemi një shpjegim të të gjitha tipareve të veprës penale në 81% të rasteve, ose në 21 rast nga gjithsej 26 raste kur është bërë pranimi i fajit. Mu për këtë arsye, në kushtet kur është bërë pranimi i fajit, ku pothuajse në gjysmën e rasteve të akuzuarit nuk kanë mbrojtës dhe shpresën e tyre për mbrojtjen e të drejtave të tyre e shohin te gjykata, konsiderojmë se është e papranueshme që gjyqtarët të mos u japin shpjegime të detajuara dhe të hollësishme të akuzuarve për atë që akuzohen, gjë që shërben si bazë për të siguruar pranim të fajit me vetëdije dhe me relevancë ligjore.

A u parashtruan pyetje për ta verifikuar pranimin e fajit në aspekt të të gjitha tipareve të veprës penale?




Grafiku nr.25

Prandaj, konsiderojmë se është e nevojshme që në këtë rast gjyqtarët të akuzuarve t'u shpjegojnë në detaje se për çfarë akuzohen, e jo vetëm t'ua lexojnë aktakuzën dhe t'i pyesin se a e kuptojnë atë. Aq më tepër pasi si një katalizator i këtij fenomeni paraqitet edhe fakti se në procedurën e shkurtuar, ku kryesisht është bërë pranimi i fajit, fjalimet hyrëse të prokurorisë nuk janë të parapara, kështu që në mungesë të mbrojtësve dhe rrethanave të aktakuzës të sqaruara në këtë mënyrë të dobët, shtrohet

²³Si duket apelet për një rol aktiv të gjykatës në vlerësimin e pranimin të fajit nuk janë gjë e panjohur për gjyqtarët, duke i pasur parasysh përvojat me sistemin e mëparshëm të procedurës penale, në të cilën gjyqtarët kishin një rol aktiv gjatë shqyrtimit kryesor. Megjithatë, përqendrimi ose ngecja në përmirësimin e kësaj situate nuk jep shumë optimizëm se gjyqtarët e kanë kuptuar plotësisht rolin e tyre në procedurën e vlerësimit të pranimi të fajit gjatë shqyrtimit kryesor. Lidhur me rolin e gjykatës në vlerësimin e pranimin të fajit, shih: Misoski B., Ilikj Dimoski D., Judges' Role in the Evaluation of the Defendant's Plea within the Sentence Bargaining Procedure, op.cit.

pyetja se a e dinë të pandehurit me të vërtetë se çfarë pranojnë. Ose, thënë ndryshe, përmes këtij qëndrimi të subjekteve në praktikë arsyetohet edhe fakti se pranimi i fajit është i papëlqyeshëm nga ana e të akuzuarve dhe se ka ngecje në zbatimin e tij.

A u parashtruan pyetje për ta verifikuar natyrën vullnetare të pranimit të fajit?



Grafiku nr.26

Përkeqësim të konsiderueshëm në krahasim me vitin e kaluar, kemi edhe në aspekt të vlerësimit të natyrës vullnetare të pranimit të fajit nga ana e gjykatës. Në fakt, për dallim nga viti i kaluar, kur gjyqtarët në 97% të rasteve kanë vlerësuar se pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare, këtë vit këtë përpjekje intelektuale ata e kanë bërë vetëm në 81% të rasteve. Nëse vitin e kaluar kemi shprehur pakënaqësi vetëm nga një rast, këtë vit duhet t'i kushtojmë vëmendje të veçantë punës së gjykatës, me qëllim që pranimin e fajit në procedurë të shkurtuar gjyqtarët të mos e marrin si "gjë të gatshme", por në vend të kësaj, të luajnë një rol aktiv dhe të vlerësojnë plotësisht se pranimi i fajit a është bërë në mënyrë vullnetare (grafiku nr.26). Përndryshe, duke e toleruar këtë praktikë të "artit për hir të artit" në aktakuza, ndodh që të kërkohet çfarëdo fajtori, e jo të kërkohet drejtësia dhe sanksion i drejtë për autorin e vërtetë. Sjellja e këtillë e gjyqtarëve, në masë të madhe shpie në përfundimin se është e domosdoshme të parashihet detyrimi ligjor për të pasur avokat mbrojtës në të gjitha rastet kur i akuzuari është i gatshëm ta pranojë fajin, pavarësisht nga pesha e vepërs penale, pasi që është më se e qartë se nevojitet një garantues plotësues i të drejtave të të akuzuarit, veçanërisht në procedurën kur i akuzuari është i gatshëm ta pranojë fajin. Zgjidhja e tanishme vetëm e inkurajon mospëlqimin e pranimit të fajit nga të akuzuarit gjatë procedurave penale.


Si pjesë e ndikimeve të fshehta mbi pranimin vullnetar të fajit, paraqiten edhe problemet e identifikuar në raportin e vitit të kaluar të Koalicionit në lidhje me zbatimin e masës së paraburgimit si një mjet për të negociuar²⁴. Është për t'u përsëritur fakti që përfundimet e vitit të kaluar në krahasim me të dhënat e këtij viti nuk mund t'i konfirmojmë me shkallë të lartë të sigurisë. Në fakt, për dallim nga vitet e kaluara kur ishim dëshmitarë se në 25% të rasteve paraburgimi është hequr menjëherë pas pranimit të fajit, nga të dhënat e këtij viti kjo praktikë është vërejtur vetëm në 2 raste ose e shprehur në përqindje, në pothuajse 8% nga numri i përgjithshëm i rasteve në të cilat është pranuar faji. Megjithatë, edhe përkundër përqindjes relativisht të ulët, si dhe dinamikës së dëshiruar për zvogëlimin e tij nga 25% në 8%, vetë fakti që kjo praktikë ende ekziston çon në përfundimin se në raste të caktuara heqja e paraburgimit mund të keqpërdoret si mjet për pranimin e detyrueshëm

²⁴Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analizë e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, op. cit., fq. 15, si dhe Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2016, Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë", Shkup, OSBE, 2016, fq. 23-24.

të fajtit. Kjo praktikë rezulton me zbatimin e gabuar si të dispozitave të LPP-së me të cilat rregullohet zbatimi i paraburgimit, ashtu edhe të dispozitave me të cilat rregullohet vlerësimi i pranimit të fajtit dhe kjo praktikë duhet të çrrënjohet.

Të apostrofuara dhe të riaktualizuara, konkluzionet e vitit të kaluar do të ishin përgjigja më e shkurtër në pyetjen se a ka parashtruar gjykata pyetje për ta verifikuar se a është i vetëdijshëm i akuzuari për pasojat nga pranimi i fajtit²⁵.

A u parashtruan pyetje për ta verifikuar se a është i vetëdijshëm i akuzuari për pasojat nga pranimi i fajtit



Grafiku nr.27

Në fakt, rënia prej 95% nga viti i kaluar në 85% këtë vit, mund të nënkuptojë vetëm riaktualizim të nevojës për trajnim plotësues të gjyqtarëve në aspekt të rolit të tyre në rastet kur personat e akuzuar e kanë pranuar fajin. Kështu, në vend që në këto raste gjyqtarët të jenë tërësisht inkuizitorë, ku lirisht do t'i parashtronin pyetje të akuzuarit me qëllim që ta qartësojnë plotësisht ngjarjen penale-juridike deri në shkallën e bindjes së tyre të plotë përtej dyshimit të arsyeshëm, ne kemi zbuluar një gjendje të pasivitetit të papranueshëm të gjykatës në 15% të rasteve në aspekt të vlerësimit të vetëdijes së të akuzuarit për pasojat nga pranimi i fajtit (grafiku nr.27).

Vetëm nëpërmjet këtyre korrigjimeve të roli i gjykatës, por edhe duke i rregulluar në mënyrë plotësuese dispozitat e LPP-së, do të mund të ndryshonte perceptimi i publikut për gjykatën si garantuese e vërtetë e të drejtave të personave të akuzuar, e cila vepron në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe ekskluzivisht në interes të drejtësisë.

Përmirësimi i vetëm në krahasim me vitin e kaluar është vërejtur në lidhje me mbështetjen me fakte të pranimit të fajtit.

²⁵ Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analizë e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, op. cit., fq. 26-27.

A u nxorën prova pas pranimit të fajit



Grafiku nr.28

Në fakt, me kënaqësi theksojmë se është ruajtur trendi i rritjes së vëllimit dhe cilësisë së provave që nxiren para gjykatës pas pranimit të fajit. Në fakt, për dallim nga përqindja e lartë e vitit të kaluar prej 69%, këtë vit në madje 76% të rasteve kur të akuzuarit e kanë pranuar fajin, janë nxjerrë prova plotësuese.

Sa i përket cilësisë së provave, edhe këtë vit, mund të jemi të kënaqur, sepse në këto raste, gjyqtarët nxjerrin më shumë prova, siç janë raporte të ekspertëve, raporte mjekësore, vërtetim për punësim, gjendje të pronës dhe të ngjashme. Megjithatë, ende prova më e shpeshtë është ekstrakti nga evidenca ndëshkuese. Krahasuar me vitin e kaluar, kur konsideruam²⁶ se me heqjen e Ligjit për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal do të zvogëlohej edhe ndikimi i evidencës ndëshkuese mbi barrën e provës, megjithatë, del se evidenca ndëshkuese ende është një provë shumë e fortë dhe e shpeshtë, pa marrë parasysh se a është paraparë rëndësia e kësaj prove në ndonjë pikë apo tabelë ligjore ose jo. Në këtë drejtim, mund të theksojmë edhe një herë se evidenca ndëshkuese është e rëndësishme, por vetëm nëse bëhet fjalë për person që është ndëshkuar më parë, gjegjësisht për persona specialë që i janë rikthyer krimit.²⁷ Përndryshe, kjo provë nuk mund të shërbejë fare për ta mbështetur pranimin e fajit të të akuzuarit gjatë shqyrtimit kryesor. Për fat të keq, ende nuk kemi qenë dëshmitarë që prova në mbështetje të pranimit të fajit të jetë edhe deklarata e dëshmitarit ose e të dëmtuarit.

Megjithatë, mund të jemi të kënaqur sa i përket trendit të përmirësimit të nxjerrjes së provave, sepse qëllimi për shkurtimin e procedurës në të cilën është pranuar faji nga i akuzuari nuk është përsëritja e gjithë procedurës së provave apo nxjerrja e të gjitha provave. Në vend të kësaj, gjykata duhet të sigurohet, përtej dyshimit të arsyeshëm, kryesisht përmes marrjes aktive në pyetje të të akuzuarit, e pastaj edhe duke i kryqëzuar faktet nga pranimi i fajit me listën e provave nga aktakuza dhe thjesht duke i nxjerrë vetëm disa prova të veçanta nga kjo listë. Në këtë mënyrë, gjykata do t'i nxjerrë vetëm provat më të rëndësishme për të, të cilat e mbështesin pranimin e fajit ose janë kundërtshënësë²⁸. Kështu, gjykata padyshim do të bindej përtej dyshimit të arsyeshëm se pranimi i fajit a është i vërtetë apo i rremë.

Për ta përmirësuar më tej situatën e konstatuar, mendojmë se është i qëndrueshëm propozimi për futjen e seancës së posaçme të provës²⁹ ku do të rivlerësoheshin provat në favor dhe në dëm të

²⁶Po aty, fq. 27.


²⁷Shih: Shih: Gruevska Drakulevski A., Recidivizmi dhe burgu, Grafoden, Shkup, 2016

²⁸Shih më shumë të: Ingram L.J., Criminal Evidence, 12-ed. Elsevier, 2015, fq. 91 etj.

²⁹Për rëndësinë e seancës së provës shih: Haddad, James B., et al, Criminal Procedure, Cases and Comments, 5-th ed. Foundation Press, New York, 1998.

vërtetësisë së pranimit të fajit. Në këtë drejtim, konsiderojmë se është e përshtatshme që në LPP të parashihen dispozita shtesë me të cilat do të rregullohej mbajtja e kësaj seance si pjesë e veçantë e shqyrtimit kryesor në kushte kur është pranuar faji nga ana e të akuzuarit. Në këtë mënyrë edhe gjyqtarët do të ishin më të lirë gjatë marrjes së vendimit se cilat prova do të nxirreshin në këtë seancë, që do të ishte me rëndësi të jashtëzakonshme për ta mbështetur vendimin e tyre. Në këtë mënyrë, konsiderojmë se do të rritej edhe besimi ndaj gjykatave gjatë marrjes së vendimit në rastet kur kemi pranim të fajit, e me këtë do të rritej edhe përqindja dhe gatishmëria e të akuzuarve për ta pranuar fajin.

Pas pranimit të fajit, a vendosi gjykata për:



Grafiku nr.29

Ndryshe nga viti i kaluar, kur gjykata, përveç për fajin, vendosi edhe për dëmin, ajo shqiptoi konfiskim të sendeve dhe vendosi për shpenzimet në 26 raste, që është më shumë se gjysma e rasteve në të cilat të akuzuarit e kanë pranuar fajin, në gjithsej 40 raste për vitin e kaluar, këtë vit kemi rënie drastike, me ç'rast gjykata, përveç sanksionit, vendosi edhe për shpenzimet edhe për dëmet vetëm në 6 nga 26 raste (grafiku nr.29). Konsiderojmë se me rritjen e përqindjes së vendimit të gjykatës, përveç për sanksionin edhe për elementet e tjera, e veçanërisht për dëmin, dukshëm rritet besimit në gjyqësi, për faktin se me anë të këtyre vendimeve plotësuese fitohet përshtypja se gjykata plotësisht e ka qartësuar ngjarjen penale-juridike në raport me të gjithë personat e interesuar. Në këtë mënyrë, publiku arrin në përfundimin se në rastet kur i akuzuari e ka pranuar fajin, të gjitha karakteristikat dhe garancitë e procedurës penale mbesin të respektuara, e me këtë edhe kjo procedurë perceptohet si e drejtë dhe e pranueshme. Për këtë arsye, konsiderojmë se gjyqtarët duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha në këto raste dhe më shpesh të marrin vendim edhe për kompensim të dëmit, e jo t'i këshillojnë palët e dëmtuara që të ngrejnë konteste civile.


PROCEDURA E PROVAVE

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj faze të shqyrtimit kryesor, pa dyshim mund të shihet pse edhe vetë ligji ka paraparë detaje mbi rrjedhën e procedurës së provave, rendin në të cilin duhet të nxirren provat në shqyrtimin kryesor, duke i dhënë prioritet përfaqësuesit të aktakuzës, gjegjësisht paditësit privat, në krahasim me mbrojtjen, por edhe atyre provave që janë në korrelacion me kërkesën pronësore-juridike, e pastaj provave të mbrojtjes dhe provave eventuale të aktakuzës, me të cilat do të bëhej përgënjeshtrimi i provave të mbrojtjes në formë të replikës, por edhe provave të mbrojtjes si përgjigje ndaj këtij përgënjeshtrimi, të quajtura duplikë. Kjo për shkak se barra e provës është transferuar në anën e përfaqësuesit të aktakuzës, kështu që ai duhet t'i paraqesë në mënyrë adekuate provat e tij, mbi të cilat bazohet aktakuza dhe ta bindë gjykatën përtej dyshimit të arsyeshëm në fajësinë personit të akuzuar.

Në procesin e procedurës së provave, gjykata ka për detyrë ta kontrollojë mënyrën dhe renditjen e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të ekspertëve dhe nxjerrjen e provave, duke mbajtur llogari për efikasitetin dhe aspektin ekonomik të procedurës dhe për përcaktimin e të vërtetës. Në këtë pjesë të procedurës, gjykata vendos edhe për kundërshtimet e palëve, me ç'rast mund të ndalojë ndonjë pyetje apo përgjigje për pyetje që tashmë është parashtruar, në qoftë se vlerëson se ajo është e palejueshme ose e parëndësishme për lëndën ose nëse pyetja e përmban edhe pyetjen dhe përgjigjen. Kuptohet, marrja në pyetje në mënyrë të kryqëzuar paraqet përjashtim nga kjo.

Në parim, menaxhimi i procesit të rregullimit dhe renditjes së nxjerrjes së provave i lihet secilës prej palëve në procedurë, kështu që ata kanë liri t'i renditin provat e tyre sipas rëndësisë së tyre për ta dëshmuar teorinë e tyre të supozuar të rastit. Megjithatë, kjo liri e dhënë rrallë zbatohet në praktikë. Shumë shpesh, gjyqtarët e përcaktojnë renditjen e nxjerrjes së provave, e shpeshherë edhe e ndryshojnë duke u nisur nga ideja për "aspektin ekonomik të procedurës". Këtë vit, për dallim nga viti 2017 kur nuk është regjistruar asnjë shmangie nga renditja ligjore e nxjerrjes së provave, u vu re se në 2% të seancave është marrë në pyetje dëshmitari i mbrojtjes para dëshmitarit të prokurorisë, sepse për provat e propozuara nga aktakuza, dëshmitarët, në momentin konkret nuk kanë qenë të pranishëm, prandaj, për arsye pragmatike, gjykata ka kaluar në marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes (grafiku nr.30).

A ishte renditja e nxjerrjes së provave sipas renditjes së paraparë me ligj?




Grafiku nr.30

Në krahasim me të dhënat e vitit të kaluar në aspekt të këshillave për të drejtat e dëshmitarëve, vërejmë gjendje identike të zbatimit të këshillave për të drejtat e dëshmitarëve. Në 90% të seancave


dëshmitarët janë këshilluar, kundrejt 10% të seancave, në të cilat këshilla nuk është dhënë. Sa i përket betimit të paraparë, megjithëse në sistemin tonë, betimi i dhënë nga dëshmitarët ende konsiderohet vetëm si një akt formal i rritjes së vlerës së deklaratës së dhënë si mjet dëshmues, ai zbatohet në një përqindje relativisht të kënaqshme nga disa gjyqtarë. Në 68% të numrit të përgjithshëm të seancave të vëzhguara, dëshmitarët u betuan gjatë dhënies së deklaratës së tyre (grafiku nr.32).

A u këshillua dëshmitari për të drejtat e tij



Grafiku nr.31

A u betua dëshmitari




Grafiku nr.32

Ligji për procedurën penale parasheh që dëshmitarët e propozuar fillimisht të merren në pyetje nga pala që i ka propozuar. Në bazë të kësaj, marrja në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë është metoda më të cilën merret në pyetje dëshmitari i propozuar me qëllim të vërtetimit të teorisë së paraqitur të rastit, me ç'rast mundësohet nxjerrja e fakteve dhe e rrethanave që janë të njohura për dëshmitarin. Nga ana tjetër, marrja në pyetje në mënyrë të kryqëzuar është një mundësi për nxjerrjen e informatave që do të shkonin në favor të palës kundërshtare dhe për t'i nxjerrë në pah dobësitë në dëshmitë e dëshmitarit³⁰. Pyetjet që zbatohen në këtë lloj të marrjes në pyetje të dëshmitarit, e të cilat vijnë nga pala kundërshtare, janë të kufizuara dhe kanë të bëjnë me pyetjet që janë parashtruar më parë, gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga pala që e ka propozuar. Implementimi i drejtë i mënyrës së marrjes në pyetje të dëshmitarëve, si dhe teknikat e palëve në procedurë, i ndoqëm dhe i vlerësuar përmes disa parametrave në procesin e procedurës së provave. Kështu, llojet e marrjes në pyetje i analizuar përmes grupeve të ndryshme të pyetjeve të formuluar sipas llojit të marrjes në pyetje, me ç'rast e përcaktuar cilësinë e parashtrimit të pyetjeve, sa ishin të kuptueshme, por dhe perceptimin për suksesin që e lënë palët kur i parashtrojnë pyetjet.


Lidhur me dhënien e mundësisë për marrje në pyetje në mënyrë të kryqëzuar për palën që nuk e ka propozuar dëshmitarin që merret në pyetje, statistikat që u përpunuan në bazë të të dhënave të mbledhura nga monitorimi i realizuar tregojnë se gjykata e respekton plotësisht të drejtën e palëve kundërshtare dhe ua jep atyre mundësinë për marrje në pyetje në mënyrë të kryqëzuar, por jo gjithmonë kjo mundësi është shfrytëzuar nga palët kundërshtare. Në fakt, në 80% të seancave, pala që ka pasur të drejtë të marrë në pyetje në mënyrë të kryqëzuar e ka shfrytëzuar këtë mundësi, ndërsa në 19% të seancave, edhe pse u është dhënë mundësia, ata kanë vendosur të mos e shfrytëzojnë atë (grafiku nr.33). Lëshimi i vetëm që është regjistruar nga vëzhguesit në 1% të seancave ka të bëjë me situatën në të cilën është tërhequr aktakuza menjëherë pas përfundimit të marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë, e me këtë edhe rrjedha logjike e procedurës e eliminon mundësinë për marrje në pyetje në mënyrë të kryqëzuar.

³⁰Mauet, Thomas A.- "Trial techniques and trials"



Grafiku nr.33


Ajo që është interesante për t'u komentuar është fakti i përkeqësimit të situatës në lidhje me kufizimin e marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar në lidhje me atë që është deklaruar gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në fakt, edhe pse përqindja në lidhje me këtë çështje, nga pozicioni fillestar në vitin 2015, gjatë viteve shënonte trend rritës, gjegjësisht përmirësim dhe implementim të drejtë të dispozitave të parapara në LPP, këtë vit shënon përkeqësim. Nga numri i përgjithshëm i seancave të vëzhguara, në vetëm 61% të tyre marrja në pyetje në mënyrë të kryqëzuar është kufizuar në marrjen në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë, për dallim nga viti 2016, kur për shembull, kjo ishte 82%, dhe është përqindja më e lartë e katër viteve në të cilat është realizuar monitorimi (grafiku nr.34).



Grafiku nr.34

Sa i përket pjesës etike, se a është zhvilluar marrja në pyetje në mënyrë të kryqëzuar duke e respektuar personalitetin e dëshmitarit, përkatësisht ekspertit, vëzhguesit kanë konstatuar gjendje që tregon qëndrim jokorrekt gjatë marrjes në pyetje (grafiku nr.35). Konkretisht, janë regjistruar dy lëndë në të cilat prokurori publik gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar është sjellë verbalisht në mënyrë agresive ndaj dëshmitarit dhe i ka sugjeruar ta thotë mendimin e tij, jo atë për të cilin është thirrur, gjegjësisht të thotë se çfarë ka parë në vendin e ngjarjes në rastin konkret.


A është zhvilluar marrja në pyetje duke e respektuar dëshmitarin/ekspertin



Grafiku nr.35

Përmirësim vërehet edhe në aspekt të vazhdimësisë së marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar, dhe kështu, siç mund të shihet nga paraqitjet grafike më poshtë, mund të vërehet një tendencë rritëse, gjegjësisht përparim, në lidhje me këtë çështje. Në vitin 2018 është vërejtur se vetëm në 12% të seancave të vëzhguara, marrja në pyetje në mënyrë të kryqëzuar është ndërprerë, ndërsa në 88% të të gjitha seancave kjo është zhvilluar pa pengesa, që paraqet përmirësim në krahasim me vitin 2016, kur ndërprerje ka pasur në 31% të seancave të vëzhguara dhe në krahasim me vitin 2017, kur ndërprerje ka pasur në 41% të seancave (grafiku nr.36).


A u zhvillua marrja në pyetje në mënyrë të kryqëzuar pa pengesa apo u ndërpre?



Grafiku nr.36


Ligji për procedurën penale në nenin 388 parasheh përjashtim nga nxjerrja e drejtpërdrejtë e provave, me ç'rast në paragrafin 2 thuhet se dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna gjatë procedurës hetimore, dhe deklaratat e mbledhura gjatë veprimeve mbrojtëse gjatë procedurës hetimore, mund të përdoren gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar ose gjatë përgënjeshtimit të konstatimeve të dhëna ose në përgjigje të përgënjeshtimit, për arsye të vlerësimit të besueshmërisë së deklaratave të dhëna në shqyrtimin kryesor. Siç mund të shihet nga paraqitja grafike nr.37, nga 91 seanca në të cilat është ndjekur procedura në këtë fazë, në dhjetë seanca kjo është kur ka pasur dëshmi jokonsekuente, në tre për shkak të përkujtimit dhe në një kur dëshmitari nuk ka dashur të përgjigjet. Ose gjithsej, bëhet fjalë për është rreth 15% të rasteve.

A u bë përjashtim nga nxjerrja e drejtpërdrejtë e provave?



Grafiku nr.37


Kur bëhet fjalë për rolin e gjykatës në procesin e nxjerrjes së provave në procedurën e provave, ai është mjaft i kufizuar. Me futjen e ndryshimeve në sistemin e procedurës penale, gjykata nuk ka më rol udhëheqës gjatë marrjes në pyetje të palëve, ashtu siç kishte sipas LPP-së së vjetër. Tani, marrjen në pyetje e bëjnë vetë palët, ndërsa për gjykatën është paraparë ta kontrollojë mënyrën dhe rendin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të ekspertëve dhe nxjerrjen e provave, duke mbajtur llogari për efikasitetin dhe aspektin ekonomik të procedurës dhe, kur është e nevojshme, për përcaktimin e të vërtetës, por edhe për dinjitetin e palëve dhe të dëshmitarëve në procedurë. Në bazë të nenit 383, paragrafi 5 të LPP-së gjykata mund të parashtrijë pyetje vetëm pasi palët ta kenë përfunduar marrjen në pyetje të tyre. Ajo që është e rëndësishme për t'u theksuar është se pyetjet e gjykatave duhet të kufizohen në sqarimin e rrethanave të caktuara që dalin nga pyetjet e parashtruara më parë gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të kryqëzuar dhe nuk duhet të shndërrohen në marrje të veçantë në pyetje. Megjithatë, te ne me vite me radhë ka një devijim nga ky rol i ri i gjykatës, dhe kështu, nga paraqitja grafike nr.38 mund të vihet re madje edhe një tendencë e rritjes së përqindjes së seancave në të cilat gjykata e ka përdorur këtë të drejtë, por jo gjithmonë ashtu siç është paraparë.



Grafiku nr.38


Kalimi i ngadaltë i gjykatës në modelin e ri të procedurës dhe braktisja e rolit të saj udhëheqës gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të ekspertëve evidentohet edhe përmes pjesës së pyetësorit që ka të bëjë me pyetjet se si gjykata e ka përdorur të drejtën e saj për të parashtruar pyetje gjatë procedurës së provave. Kështu, të dhënat tregojnë se gjykata në 4 raste e ka "keqpërdorur" të drejtën e saj për të marrë në pyetje që ka rezultuar me marrje krejtësisht të veçantë në pyetje të kryer nga gjykata (grafiku nr.39).

Marrja në pyetje nga ana e gjykatës



Grafiku nr.39


Për dallim nga viti i kaluar, kemi vërejtur rritje edhe të numrit të zbatimit të kundërshtimeve në procedurë, veçanërisht të atyre të bëra nga ana e prokurorisë publike. Nëse në vitin 2017 ky numër ishte 19, në 2018 ky numër është 27. Rritje minimale të numrit të seancave ku janë paraqitur kundërshtime vërejmë edhe te mbrojtësit, prej 16 në 18 (grafiku nr.40).



Grafiku nr.40

Sipas LPP-së, gjykata ka për detyrë ta kontrollojë mënyrën dhe rendin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve në aspekt të lejueshmërisë së pyetjeve, vlefshmërisë së përgjigjeve, marrjes së drejtë në pyetje dhe arsyeshmërisë së kundërshtimeve. Vëzhguesit e Koalicionit kanë vërejtur 5 seanca ku gjykata nuk është kujdesur për lejueshmërinë e pyetjeve, vlefshmërinë e përgjigjeve dhe marrjen e drejtë në pyetje, ndërsa në 34 seanca kanë konsideruar se nuk ka nevojë për ndërhyrje nga gjykata, sepse procedura është respektuar në tërësi dhe është zbatuar në përputhje me autorizimet dhe rolet e palëve në procedurë.

Kryetari i këshillit nuk vendos vetë për rendin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve të propozuar nga palët, por vetë palët vendosin se me çfarë renditje do t'i nxjerrin provat e propozuara. Rendi i nxjerrjes së provave është i rëndësishëm sepse secila nga palët paraprakisht ka përgatitur një plan për ta dëshmuar teorinë e saj të rastit dhe sipas këtij plani e bën edhe renditjen e nxjerrjes së provave.³¹ Gjatë përpjekjes për të përcaktuar se në çfarë mënyre u nxorën provat e shkruara dhe provat e tjera materiale, hasëm në statistikën e mëposhtme: nga 415 seanca të vëzhguara, në 48 seanca, gjykata i ka nxjerrë provat, gjegjësisht gjykata i ka prezantuar ato, ndërsa në 24 seanca, provat i ka nxjerrë pala që i ka propozuar ato (grafiku nr.41).




Grafiku nr.41

Neni 391, paragrafi 1 i LPP-së parasheh se i akuzuari merret në pyetje vetëm me propozim të mbrojtjes. Me futjen e kësaj dispozite në ligj, krejtësisht braktiset parimi i marrjes në pyetje të të akuzuarit në procedurë në çdo rast, e sidomos për shkak të nevojës së prokurorisë për ta dëshmuar akuzën e saj. Në këtë mënyrë, të akuzuarit i mundësohet të mos merret në pyetje në procedurë, gjegjësisht kjo mundësi i lihet në dispozicion mbrojtjes dhe braktiset koncepti i përdorimit të së drejtës për heshtje, sa herë që ai do t'i shmangej dëshmimit, gjegjësisht kur konsideron se nuk duhet të japë dëshmi. Nëse nga mbrojtja është dhënë propozim për marrje në pyetje të të akuzuarit, ai gjatë shqyrtimit merret në pyetje në pajtim me rregullat që zbatohen dhe vlejné për marrjen në pyetje të dëshmitarëve, gjegjësisht ekspertëve, në aspekt të llojeve të marrjes në pyetje, me atë që i akuzuari nuk e merr automatikisht statusin e dëshmitarit në procedurë, por, përkundrazi, ai e ruan statusin e të akuzuarit, e me këtë edhe të drejtat që i ka si i akuzuar.

Nga të dhënat që vëzhguesit i kanë mbledhur gjatë vitit të kaluar, e që kanë të bëjnë me të akuzuarit në procedurë, do t'i paraqesim statistikën për marrjen në pyetje të të akuzuarve sa i përket veprave penale (grafiku nr.42), marrjen në pyetje sa i përket rrethanave që janë të rëndësishme për përcaktimin e dënimit (grafiku nr.43), si dhe marrjen në pyetje të të akuzuarit që nuk ka avokat mbrojtës në procedurë (grafiku nr.44). Nga të dhënat e analizuara, si të dhëna me rëndësi të veçantë mund t'i veçojmë ato që kanë të bëjnë me pjesën e marrjes në pyetje të të akuzuarit pa mbrojtës në procedurë, pastaj mund ta theksojmë pjesëmarrjen e gjykatës në marrjen në pyetje të të akuzuarit (57%), gjë që është në kundërshtim me atë që e parasheh LPP-ja si kompetencë e gjykatës.


31 Kallajxhiev G., Llazhetiq G., Nedellkova L., Denkovska M., Trombeva M., Vitllarov T., Jankullovska P., Kadiev D., Koment i Ligjit për procedurën penale, OSBE, Shkup, 2018

Marrja në pyetje e të akuzuarit sa i përket veprës penale



Grafiku nr.42

Marrja në pyetje e të akuzuarit për rrethanat që janë të rëndësishme për përcaktimin e dënimit



Grafiku nr.43

Marrja në pyetje e të akuzuarit që nuk ka mbrojtës



Grafiku nr.44


Në lidhje me atë se a është lexuar dëshmia e të akuzuarit që e ka dhënë në procedurën paraprake, të dhënat tregojnë se në 3% të rasteve kjo dëshmi është lexuar për shkak të dëshmisë së ndryshme të dhënë në shqyrtim, ndërsa në 2% të rasteve për shkak se i akuzuari nuk ka dhënë dëshmi në shqyrtim (grafiku nr.45).



Grafiku nr.45

Neni 374 i LPP-së e rregullon mënyrën e regjistrimit të shqyrtimit kryesor, ndërsa në paragrafët 1 dhe 2 më detajisht thuhet se "rrjedha e shqyrtimit kryesor incizohet me zë ose në mënyrë vizuale-me zë" dhe "në fillim të shqyrtimit, kryetari i këshillit i njofton palët e pranishme dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë për atë se shqyrtimi incizohet, dhe se incizimi paraqet shënim vizuel-me zë nga shqyrtimi i mbajtur." Nëse i shikojmë të dhënat e analizuara për këtë çështje, të cilat janë paraqitur në mënyrë vizuale në grafikun nr.46, do të vërejmë se këtë vit, për dallim nga vitet e kaluara, kemi numër më të madh të shqyrtimeve që regjistrohen me incizim vizual-me zë. Në analizën e vitit të kaluar³² njëra nga gjendjet e konstatuara për të cilën apeluaam që të ndryshohet ishte pikërisht incizimi i shqyrtimeve, pasi që asnjëra nga shqyrtimet e vëzhguara nuk ishte incizuar. Sidoqoftë, ende brengos praktika që vazhdon edhe këtë vit, e ajo është numri i madh i shqyrtimeve që regjistrohen me diktim nga ana e kryetarit të këshillit në procesverbal.

32 Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, Shkup, Misioni i OSBE-së - Shkup 2017.




Grafiku nr.46

■ E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË

Barazia e armëve

E drejta për gjykim të drejtë edhe këtë vit është analizuar përmes disa elementeve që janë pjesë përbërëse e definicionit për gjykim të drejtë. Së pari, barazia e armëve, si një nga elementet më të rëndësishme të nocionit gjykim i drejtë, kërkon mundësi të barabarta për përgatitjen e rastit nga ana e palëve, si dhe mundësi të barabarta për prezantimin e çështjes para një arbitri të pavarur. Pavarësia e gjykatës vlerësohet mu nëpërmjet asaj se si i trajton palët. Në këtë drejtim vërehet një përkeqësim i lehtë i situatës në krahasim me vitin e kaluar. Përderisa në vitin 2017 trajtimi i pabarabartë nga ana e gjykatës ndaj prokurorit dhe mbrojtjes është regjistruar në vetëm një rast, këtë vit vëzhguesit trajtim të pabarabartë kanë vënë re në më shumë se 5 raste ose, e shprehur në përqindje, në 4% të rasteve (grafiku nr.47).

A u trajtuan në mënyrë të barabartë mbrojtja dhe prokurori nga gjyqtari në lidhje me kundërshtimet




Grafiku nr.47

Megjithatë, përkundër faktit se bëhet fjalë për një përkeqësim të lehtë në krahasim me vitin e kaluar, brengos fakti që qëndrimi i këtyllë nga ana e gjykatës nuk zvogëlohet, por përkundrazi rritet për dy vjet me radhë. Edhe pse, në të vërtetë, bëhet fjalë për një numër shumë të vogël të rasteve, megjithatë, konsiderojmë se gjyqtarët dhe prokurorët, dhe mbrojtësit si palë, në të ardhmen duhet t'u

kushtojnë më shumë vëmendje raporteve të ndërsjella dhe ato t'i ndërtojnë në nivel profesional edhe atë, kryesisht, përmes respektimit të gjykatës dhe respektit të ndërsjellë.

Konfirmim të rezultatit nga viti i kaluar kemi në lidhje me pyetjen se a i ka pasur mbrojtja mundësitë e njëjtat sikurse prokuroria në propozimin e provave (grafiku nr.48). Në përqindje të njëjtë prej 2% sikurse edhe vitin e kaluar, gjegjësisht në 4 raste në vitin 2018, vëzhguesit kanë vënë re se mbrojtja nuk i ka pasur mundësitë e njëjta për të propozuar prova. Sidoqoftë, përkundër faktit se bëhet fjalë për disa raste, do të ishte interesante të ishim në gjendje t'i vlerësojmë arsyet për shkak të të cilave gjykata i ka marrë këto vendime, për të bërë një vlerësim të drejtë për atë se a bëhet fjalë me të vërtetë për shkelje të parimit të barazisë së armëve të palëve apo bëhet fjalë për mbrojtjen e gjykatës për "t'u mos u rënë në qafë" palët. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e vëzhgimit të gjykimeve, në këtë situatë mundemi vetëm t'i regjistrojmë mospërputhjet e identifikuara, me qëllim që ato të trajtohen në mënyrë adekuate në të ardhmen nga gjykata dhe palët në procedurë.

A i kishte mbrojtja mundësitë e njëjta sikurse edhe prokuroria për të propozuar prova?




Grafiku nr.48

Duke pasur parasysh se në këtë rast kemi situatë të njëjtë dhe një përqindje relativisht të vogël, mendojmë se në këtë drejtim nuk duhet të konstatojmë ndonjë problem serioz në aspekt të trajtimit të barabartë të palëve nga ana e gjykatës gjatë shqyrtimit kryesor. Kuptohet që ky parim sfidat më të mëdha i ka gjatë procedurës paraprake, prandaj konsiderojmë se ndryshimet e ardhshme në LPP do të duhet ta përfshijnë përmirësimin e trajtimit të avokatit mbrojtës gjatë procedurës paraprake.

Parimi i transparencës


Sa i përket parimit të transparencës, si parim jashtëzakonisht i rëndësishëm për të drejtën për gjykim të drejtë dhe si një nga elementet më të rëndësishme për rritjen e besimit në pavarësinë e gjyqësisë, mund të konstatojmë disa gjëra. Në fakt, ashtu sikurse dhe në vitin e kaluar, seancat kanë qenë kryesisht publike, me atë që publiku është përjashtuar vetëm në një përqindje të vogël të rasteve, gjegjësisht vetëm në 6 shqyrtime (grafiku nr.49). Në përqindje, të dhënat e këtij viti janë në nivelin e vitit të kaluar, gjegjësisht kjo ka ndodhur vetëm në 2% të rasteve të vëzhguara. Megjithatë, për fat të keq, kjo praktikë vazhdon në raste të veçanta, këtë vit në 1% ose vetëm në 3 seanca (grafiku nr.50), publiku dhe mediat janë penguar ose janë përjashtuar në mënyrë të padrejtë nga seanca, gjë që përsëri na çon në përfundimin e vitit të kaluar se ka nevojë t'i kushtohet vëmendje e veçantë zbatimit të dispozitave të procesit për përjashtimin e publikut, e sidomos të mediave, si krijues kryesorë të opinionit publik.

A ishte publik gjykimi?



Grafiku nr.49


A u përguan përfaqësuesit e publikut apo të mediave të marrin pjesë në gjykim?



Grafiku nr.50

Në lidhje me publikimin e kohës dhe sallës së gjyqit në të cilën do të mbahen gjykimet, si një element i rëndësishëm i parimit të transparencës së gjykimeve, konsiderojmë se nuk ka përmirësime në krahasim me vitin e kaluar. Në fakt, publikimi i këtyre informatave është shumë i rëndësishëm për rritjen e besimit të publikut në gjyqësi, si dhe për përshtypjen e përgjithshme të funksionimit të gjyqësisë. Në fakt, në qoftë se bëhet fjalë për publikimin e informatave për sallën me kohën e saktë dhe numrin e lëndës, atëherë publiku nxjerr përfundimin se bëhet fjalë për një pushtet të organizuar që e di se çfarë punon dhe ku të gjitha shqyrtimet janë publike (transparente) dhe se qytetarët kanë qasje të lehtë në to. Përndryshe, përfundimet që imponohen te qytetarët gjatë kontaktit të tyre me gjykatat, si dhe përfundimet që dalin nga vështirësitë e tyre për t'i gjetur dhe për t'i ndjekur me lehtësi seancat gjyqësore, e me këtë edhe e drejta e tyre për drejtësi, kuptohet se ndikojnë në rritjen e mosbesimit në pushtetin gjyqësor në tërësi.

A u publikuan vendi dhe koha e gjyqimit në tabelën jashtë sallës së gjyqit?



Grafiku nr.51

Këtë vit përkeqësim kemi madje edhe në krahasim me të dhënat e vitit të kaluar, gjegjësisht rritje të përqindjes së informatave që nuk janë publikuar në kohë për vendin dhe kohën e gjykimeve, edhe atë nga 21% në vitin e kaluar në 36% sivjet, ose edhe në 140 seanca të zhvilluara këtë vit (grafiku nr.51). Arsyet për këtë problem janë të qarta: investimet e pamjaftueshme në kapacitetet teknike, por edhe në ato njerëzore të gjykatave, pasi që ka mungesë të mjeteve teknike dhe të kuadrit që do t'i shfaqnin në kohë këto të dhëna në ekranet dhe vendet përkatëse në gjykatë.³³

³³Le të shpresojmë se kjo përqindje do të përmirësohet nga viti i ardhshëm, duke pasur parasysh faktin se më në fund këtë vit, Gjykata Themelore Shkup 1 do të zhvendoset dhe do të funksionojë në hapësirat e reja dhe moderne për punë. Mirëpo, kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se intensiteti i investimeve në gjykatat në të gjithë vendin duhet të ndërpritet ose zvogëlohet.


■ PARIMI I PAANSHMËRISË

Paanshmëria, tradicionalisht, vlerësohet nëpërmjet informacionit se a është kërkuar nga palët gjatë procesit gjyqësor përjashtimi i gjyqtarëve ose i anëtarëve të porotës që janë pjesë e këshillit gjyqësor. Kjo variabël për vlerësimin e anshmërisë së gjykatës i takon grupit të variablave të dukshme, meqë arsyet për përjashtim sipas detyrës zyrtare janë të përcaktuara në nenin 33 të LPP-së, ndërsa bazat e tjera i theksojnë palët gjatë seancave kur plotësohen kushtet sipas nenit 35 të LPP-së, gjegjësisht kur palët dyshojnë në paanshmërinë e gjykatës dhe ato janë lehtësisht të dukshme për vëzhguesit, me ç'rast në vlerësim nuk është përfshirë përshtypja personale e vëzhguesit.

Këtë vit kemi rritje të numrit të kërkesave për përjashtimin e gjyqtarëve në krahasim me vitin e kaluar edhe atë për 100%, ose në 4 raste, gjegjësisht në 1% të seancave të vëzhguara. Megjithatë, për dallim nga viti i kaluar, nuk bëhet fjalë për përjashtim sipas nenit 33 të LPP-së, por për përjashtim për shkak të dyshimit nga ana e palëve në paanshmërinë e gjykatës, në pajtim me nenin 35 të LPP-së. Shifra e përqindjes në këtë rast nuk duhet të merret parasysh, por duhet të analizohet numri i rasteve. Gjegjësisht, në 4 raste, palët kanë shprehur dyshim për paanshmërinë e gjyqtarëve për arsye të tjera përtej bazave për përjashtim të detyrueshëm sipas nenit 33 të LPP-së. Përkundër faktit që mund të shprehim kënaqësi që gjykata, këtë vit, i ka respektuar plotësisht dispozitat për përjashtimin e detyrueshëm, megjithatë konsiderojmë se kundërshtimet e palëve sa i përket anshmërisë sipas nenit 35 të LPP-së duhet të merren parasysh seriozisht nga gjykata. Në këtë drejtim, konsiderojmë se vendimi i gjykatës lidhur me këto kundërshtime duhet domosdoshmërisht të shpjegohet, sepse vetëm përmes aktvendimeve të arsyetuara në mënyrë adekuate mund të ndikohet në masë të madhe në përshtypjen se kemi të bëjmë me një veprim të drejtë dhe korrekt të gjykatës.

Grupi i dytë i variablave përmes të cilave vlerësohet paanësia e gjykatës gjatë shqyrtimit kryesor është i karakterit më delikat, pasi që për zbatimin e tyre me rëndësi kyçe është perceptimi i vëzhguesve. Kështu, sa i përket pyetjes se a është fituar nga ana e publikut përshtypja se gjykata tashmë ka formuar mendim për rastin (grafiku nr.52), mund të konstatojmë se në 3% të rasteve, vëzhguesit fituan përshtypjen se gjykata kishte marrë vendim paraprakisht sa i përket fajit të personit të akuzuar.

A kishte lënë gjykata përshtypjen se tashmë kishte formuar mendim për lëndën?



Grafiku nr.52


Kjo do të thotë se në gjashtë seanca nga numri i përgjithshëm i seancave të vëzhguara, gjyqtarët kanë lënë përshtypjen se që më parë kishin marrë qëndrim për atë se a është i akuzari fajtor apo jo. Kjo përqindje përputhet edhe me tendencat e vitit të kaluar, gjë që çon në përfundimin se ndoshta

bëhet fjalë edhe për modus operandi nga disa gjyqtarë, me atë që sillen në mënyrë më të rreptë ndaj të akuzuarve ose tregojnë iniciativë më të madhe për t'i marrë në pyetje dëshmitarët dhe ekspertët. Kështu, nganjëherë edhe roli i shtuar aktiv i gjyqtarit, në kushte kur në LPP nuk është definuar deri në fund se a duhet gjyqtarët duhet t'u parashtrojnë pyetje dëshmitarëve pas mbrojtësve ose prokurorit publik, pas marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar me qëllim që të sqarohen faktet, mund të vlerësohet si anshmëri ndaj ndonjëres nga palët.

Mu për këtë arsye, konsiderojmë se roli i këtillë i gjykatës, që më tepër është karakteristikë e sistemit të përzier të drejtësisë penale-të procesit, duhet të çrrënjoset nga praktika e gjyqtarëve, ndërsa nga ana tjetër, prokurorët dhe mbrojtësit duhet t'i avancojnë aftësitë e tyre për marrje të drejtpërdrejtë dhe të kryqëzuar në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve, me ç'rast do të minimizohej nevoja për përfshirjen e gjykatës me pyetjet e saj, pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve nga palët.

Është interesante të theksohet se mbetet trendi nga vitet e kaluara në masën prej 1%, ose në 3 raste, kur gjykata i ka frikësuar të akuzuarit (grafiku nr.53). Konsiderojmë se për këtë praktikë nuk ka asnjë arsyetim dhe duhet të çrrënjoset nga gjykatat. Për më tepër, konsiderojmë se kjo praktikë nuk duhet të zbatohet në rastet kur i akuzuari e ka pranuar fajin.

A i kishte frikësuar gjykata të akuzuarit me sjelljen e saj?




Grafiku nr.53

Vetëm përmes çrrënjosjes së këtyre rasteve, pavarësisht nga fakti se bëhet fjalë për një përqindje shumë të vogël, gjykata mund të vlerësohet si plotësisht e paanshme, ndërsa shqyrtimi kryesor si mundësi për përballjen e barabartë të argumenteve dhe provave nga prokuroria nga njëra anë me argumentet dhe provat e të akuzuarit, i cili në këtë procedurë është i mbrojtur edhe me supozimin e pafajësisë.

Është për t'u përshëndetur fakti që për disa vite me radhë nuk mund të jemi dëshmitarë të diskriminimit nga gjykatat në bazë të racës ose gjinisë.

Një variabël interesante për vlerësimin e anshmërisë së gjykatës është edhe fakti se a ka pasur kujdes gjykata gjatë seancave apo jo. Në këtë drejtim, kemi një rritje të vogël të numrit të seancave nga 5 në 2017 në 10 këtë vit, ose në gjithsej 5% të seancave, është vënë re se gjyqtarët nuk i kanë kushtuar vëmendje të mjaftueshme asaj që ka ndodhur në sallën e gjyqit (grafiku nr.54).

A ka pasur kujdes gjykata gjatë mbajtjes së seancës?



Grafiku nr.54

Konsiderojmë se kjo variabël lidhet drejtpërsëdrejti me variablën e mësipërme sa i përket përshtypjes së formuar paraprakisht nga gjykata për atë se a është i akuzuari fajtor apo jo. Kështu, mund të interpretohet se gjykata ka qenë në një farë mënyre "e hutuar" për faktin se tashmë kishte formuar mendim dhe asgjë nuk mund t'ia ndryshonte mendjen gjatë shqyrtimit kryesor. Konsiderojmë se duhet të eliminohet kjo praktikë nga gjyqtarët, me qëllim që të përmirësohet perceptimi i publikut se gjykata është i vetmi arbitër i pavarur dhe i drejtë në kontestin konkret penal-juridik.

Në vijë të njëjtë është edhe informata që ka të bëjë me komunikimin e gjykatës me palët. Gjegjësisht, për disa vite me radhë potencojmë se është e nevojshme të zhvillohet një trajnim plotësues me subjektet e procedurës penale me qëllim që të eliminohet komunikimi joadekuat ex parte midis gjykatës dhe palëve.

A është regjistruar komunikim joadekuat ex-parte?



Grafiku nr.55

Kështu, pavarësisht nga fakti se këtë vit komunikim joadekuat ex parte është vërejtur në 3% të gjykimeve të vëzhguara, që paraqet rënie në krahasim me vitin e kaluar kur kjo përqindje ishte 8%, konsiderojmë se ende ka hapësirë për përmirësim me qëllim të eliminimit të plotë të kësaj forme joadekuatë të komunikimit ndërmjet gjykatës dhe palëve (grafiku nr.55). Gjegjësisht, gjykatat duhet të vazhdojnë me trajnimin me qëllim të njohjes së iniciativave për komunikimin ex parte me palët. Në fakt, përmes njohjes dhe eliminimit të kësaj forme të komunikimit, gjykata mund t'i kufizojë rastet kur palët përpiqen të krijojnë një imazh të pretenduar se mund të ndikojnë ndryshe në rezultatin e kontestit përtej vlerës së vërtetë të provave me të cilat disponojnë, me ç'rast drejtpërdrejt ndikohet në përmirësimin e perceptimit për gjykatën si një arbitër i paanshëm.


■ SUPOZIMI I PAFAJËSISË

Supozimi i pafajësisë si një pjesë veçanërisht e rëndësishme e të drejtës për gjykim të drejtë në pyetësorin tonë është trajtuar nëpërmjet disa ndryshoreve. Pyetja e parë ka të bëjë me nxjerrjen e përfundimeve negative nga gjykata në kushte kur i akuzuari mbrohet me heshtje. Në bazë të lëndëve të vëzhguara, është për t'u përhëndetur fakti se vëzhguesit tanë nuk kanë vërejtur asnjë rast kur gjykata ka nxjerrë përfundim negativ në lidhje me të akuzuarin i cili është mbrojtur me heshtje.

Megjithatë, nëse krahasohen të dhënat e tjera, mund të përfundojmë se ende ekzistojnë probleme të caktuara sa i përket supozimit të pafajësisë. Së pari mund të veçohen problemet e presionit nga ana e gjykatës mbi të akuzuarit, sipas të dhënave të mësipërme, ku është konstatuar se në 3 seanca, ose në 1% të gjykimeve të vëzhguara, gjykata e ka frikësuar të akuzuarin. Përveç kësaj, një përqindje pak më e lartë, ose 3%, u vërejt edhe në përgjigjet e dhëna në pyetjen "A kishte diçka që do të sugjeronte se nuk është respektuar parimi i supozimit të pafajësisë?"

Nëpërmjet këtyre përgjigjeve, mund të konstatojmë se në një farë mase, kemi trendin e njëjtë sikurse edhe vitin e kaluar në rastet kur të akuzuarit i ishte kufizuar e drejta e garantuar për supozim të pafajësisë. Gjegjësisht, prej 3% vitin e kaluar, këtë vit kemi një rritje minimale në 4% (grafiku nr.56). Mu për këtë arsye, përsëri e shprehim shqetësimin e vitit të kaluar se ende ekziston praktika e gjykatave në disa raste ta kufizojnë supozimin e pafajësisë së të akuzuarit, me ç'rast gjykata në vend të garantuesit të të drejtave të të akuzuarit, paraqitet si faktor kufizues. Mu për këtë arsye, konsiderojmë se është e domosdoshme çrrënjësja e kësaj praktike në mesin e gjyqtarëve, aq më tepër pasi që gjykata është garantuesi i vetëm në kushte kur, sipas LPP-së, janë paraparë kufizime të caktuara të të drejtave të të akuzuarve, e kryesisht duke i pasur parasysh procedurat për përshpejtimin e procedurës penale.

A kishte diçka që do të sugjeronte se nuk është respektuar parimi i supozimit të pafajësisë?




Grafiku nr.56

■ MBROJTJA EFIKASE

Edhe këtë vit, sikurse edhe vitin e kaluar, e drejta për mbrojtje efikase nga vëzhguesit u analizua përmes një sërë pyetjesh që kishin të bëjnë me efikasitetin e mbrojtësve në përfaqësimin e teorisë së tyre për rastin gjatë shqyrtimit kryesor dhe në aspekt të qasjes së mbrojtjes te provat dhe vlerësimin të kohës adekuate për përgatitjen e mbrojtjes.


A keni përshtypje se mbrojtësit nuk arrijnë t'i përfaqësojnë klientët e tyre në mënyrë adekuate?



Grafiku nr.57

Me kënaqësi mund të konstatojmë se këtë vit, vëzhguesit tanë kanë vërejtur një përmirësim të dukshëm në efikasitetin e mbrojtjes që e kanë marrë të akuzuarit nga mbrojtësit e tyre. Për dallim nga viti i kaluar kur vëzhguesit tanë kanë vërejtur mbrojtje joefikase nga ana e mbrojtësve në 14% të seancave të vëzhguara, këtë vit kjo përqindje u zvogëlua në vetëm 5% (grafiku nr.57). Kështu, mund të konstatojmë se gjatë kësaj periudhe, mbrojtësit në përgjithësi kanë bërë përpjekje plotësuese si në aspekt të përmirësimit të njohurive teorike, ashtu edhe në aspekt të përmirësimit të aftësive të tyre për zbatimin e LPP-së. Nga këto të dhëna, me një dozë të caktuar të përmbajtjes, mund ta nxjerrim edhe përfundimin se në vend gradualisht bëhet një dallim i brendshëm ndërmjet mbrojtësve në aspektin të specializimit në angazhimin profesional, gjë që çon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ata ua ofrojnë klientëve të tyre.


A u ankua mbrojtja se:



Grafiku nr.58

Një përkeqësim i caktuar në krahasim me vitin e kaluar në fushën e mbrojtjes efikase mund të konstatojmë në ankesat që mbrojtësit i kanë pasur sa i përket qasjes në prova. Në fakt, për dallim nga 9 raste në vitin 2016 dhe 8 raste në vitin 2017, në vitin 2018 mbrojtësit në 16 raste janë ankuar se janë përballur me kufizime nga ana e gjykatës në qasjen në prova (grafiku nr.58). Kjo patjetër duhet të trajtohet si një kufizim serioz i të drejtës për mbrojtje efikase, sidomos gjatë shqyrtimit kryesor. Madje edhe sikur të mund të gjejmë ndonjë arsytim për kufizimin e qasjes në prova gjatë hetimit, i cili, në përgjithësi, është i fshehtë dhe kur prokurori publik ende nuk disponon me sasi të mjaftueshme të provave, kështu që zbulimi eventual i të gjitha provave do të mund ta pengonte dhe ta dëmtonte hetimin, gjatë shqyrtimit kryesor, këto argumente, thjesht janë të pakuptimta. Mu për këtë arsye është e çuditshme praktika e gjykatës për ta kufizuar të drejtën për t'i inspektuar provat apo praktika e cila ende vazhdon për inspektim të kufizuar të provave, në kushte kur ka disa të akuzuar, kur gjykata mbrojtësve u lejon inspektim vetëm në një pjesë të provave, për të cilat gjykata vendos se kanë të bëjnë me të akuzuarin. Konsiderojmë se është e domosdoshme të çrrënjoset kjo praktikë e gjykatave, sepse nuk mund të gjendet asnjë arsytim as teorik e as praktik për të. Aq më pak gjatë shqyrtimit kryesor, i cili është dhe duhet të trajtohet si fushë për respektimin e plotë të të drejtave të të akuzuarit, e në plan të parë edhe të drejtën për mbrojtje.


A u ankua mbrojtja se koha për përgatitjen e mbrojtjes nuk ka qenë e mjaftueshme ose se ka pasur kufizime?



Grafiku nr.59

Nga ana tjetër, kënaq përmirësimi i evidentuar sa i përket kohës për përgatitjen e mbrojtjes. Në fakt, këtë vit, për dallim nga viti i kaluar, duket se gjykatat kishin më shumë mirëkuptim për nevojat e mbrojtësve për përgatitjen e mbrojtjes, të cilët, këtë vit u ankuan se nuk kishin kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur në vetëm 3% të rasteve. Gjegjësisht, kemi regjistruar rënie prej 6% në vitin e kaluar në 3% këtë vit (grafiku nr.59).

A u këshillua i akuzuari për të drejtën për të drejtën për ndihmë juridike falas?



Grafiku nr.60

Në krahasim me vitin 2017, vërejmë përmirësim në aspekt të parimit për qasjes në avokat mbrojtës dhe në aspekt të të drejtës për ndihmë juridike falas. Në fakt, për dallim nga viti i kaluar kur kjo e drejtë e të akuzuarve nuk iu shpjegua të akuzuarve nga ana e gjykatës në një të katërtën e lëndëve, ose 26% në vitin 2018, kemi përmirësim prej pothuajse 10%, gjegjësisht në 85% të rasteve gjyqtarët i kanë informuar në mënyrë adekuate të akuzuarit për këtë të drejtë të tyre (grafiku nr.60).


Duke e pasur parasysh rëndësinë e pranisë së avokatit gjatë procedurës penale, e sidomos gjatë shqyrtimit kryesor, ku vijnë në shprehje të plotë aftësitë e avokatit për zbatimin e drejtë të elementeve të shqyrtimit kryesor akuzator, mendojmë se është e nevojshme të përsëritet përfundimi nga analiza e vitit të kaluar. Gjegjësisht, kërkojmë të rishikohen dispozitat e LPP-së me qëllim të rritjes së bazës ligjore për prani të detyrueshme të avokatit mbrojtës gjatë procedurave penale, e sidomos gjatë procedurave penale që zhvillohen për veprat penale për të cilat është paraparë dënim me burg deri në 5 vjet. Në këtë drejtim, konsiderojmë se ky përfundim është njohur edhe nga ana e gjyqtarëve pikërisht nëpërmjet rritjes së këshillave për të të drejtat e të akuzuarve për praninë e mbrojtësve. Mu për këtë arsye, edhe në e lidhim të drejtën për ndihmë juridike falas me mbrojtjen e detyrueshme, me qëllim që të rritet mundësia për prani të mbrojtjes, jo vetëm në rastet kur është e nevojshme të jenë të pranishëm në përputhje me dispozitat e LPP-së, por edhe në të gjitha rastet tjera kur nuk bëhet fjalë për mbrojtje të detyrueshme, por të akuzuarit duan që të drejtat e tyre t'i mbrojnë avokati mbrojtës, mirëpo për shkak të mjeteve të kufizuara financiare, ata nuk mund t'ia ofrojnë këtë vetes.

■ E DREJTA PËR PËRKTHYES-INTERPRETUES

E drejta për përkthyes ose interpretues është paraparë në nenin 9 të LPP-së dhe tregon se pjesëmarrësit në procedurë - i akuzuari, i dëmtuari, paditësi privat, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë që flasin në gjuhë tjetër zyrtare, të ndryshme nga gjuha maqedonase, kanë të drejtë ta përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në procedurë. Kjo e drejtë vlen edhe për personat e tjerë në procedurë që mund të paraqiten në cilësinë e palëve, dëshmitarëve etj., nëse ata nuk e kuptojnë ose nuk e flasin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Organi që e zhvillon procedurën është i obliguar të sigurojë përkthim me gojë të asaj që e thonë personi dhe të tjerët, si dhe përkthim me shkrim të dokumenteve dhe të materialeve tjera të shkruara. Përkthimin e bën përkthyesi, gjegjësisht interpretuesi i autorizuar gjyqësor.

Gjatë analizës së të dhënave nga monitorimi i realizuar mund të vërehet se vetëm në 1 seancë nuk është caktuar përkthyes, ndërsa në një numër të madh të seancave, të akuzuarit as që kanë pasur nevojë për përkthyes, kështu që vetëm në 14 seanca është caktuar përkthyes menjëherë. Edhe pse është regjistruar vetëm një rast, kjo nuk duhet të jetë e pranueshme, veçanërisht pasi që ligji është i qartë dhe konciz në lidhje me palët në procedurë që nuk e kuptojnë gjuhën në të cilën zhvillohet procedura (grafiku nr.61).

A kishte nevojë i akuzuari për përkthyes dhe a iu caktua ai menjëherë?



Grafiku nr.61

■ SHPALLJA E AKTGJYKIMIT


Ligji parasheh që aktgjykimi të shpallet menjëherë pasi që gjykata ta ketë shqiptuar atë. Nëse gjykata nuk është në gjendje ta shqiptojë aktgjykimin ditën e njëjtën pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, ajo do ta shtyjë shpalljen e aktgjykimit më së shumti për tre ditë dhe do ta caktojë kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit. Shqiptimi i aktgjykimit lexohet publikisht nga kryetari i këshillit në praninë e palëve, përfaqësuesve të tyre ligjorë, të autorizuarve të tyre dhe avokatëve, por ai është i obliguar që shkurtimisht t'i paraqesë edhe arsyet për marrjen e aktgjykimit të tillë.

Pas analizimit të të dhënave, të cilat u krahasuan me vitet e kaluara, mund të shihet qartë se gjykata gjithnjë e më pak i zbaton dispozitat e detyrueshme ligjore që kanë të bëjnë me shpalljen e aktgjykimit (grafiku nr.62). Nëse në vitin 2016³⁴ përqindja e aktgjykimeve të shpallura publikisht ka arritur pikën më të lartë, kjo përqindje zvogëlohet në vitin 2017³⁵, ndërsa në vitin 2018 është përqindja më e ulët e shënuar deri më tani.

³⁴Petrovska N., Misoski B., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2016, Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, OSBE, Shkup 2016

³⁵Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, Shkup, OSBE, Shkup 2017


Shpallja e aktgjykimit



Grafiku nr.62

Në bazë të kësaj, mund të nxirret edhe përfundimi se përqindja e aktgjykimeve të pashpallura rritet nga viti në vit. Në vitin 2018, kjo përqindje është dyfishuar në krahasim me vitin 2016 kur ajo ka qenë vetëm 26%, megjithëse edhe në analizë është thënë se ka ulje të kësaj përqindjeje dhe rritje të transparencës së gjykatës në aspekt të punës së saj përmes shpalljes publike të aktgjykimeve të marra (grafiku nr.63).

Aktgjykimet e pashpallura



Grafiku nr.63


Edhe pse gjykata ka për obligim që personit të akuzuar t'ia shpjegojë kushtet për ankesë, të drejtën për ankesë dhe përgjigje ndaj ankesës, kjo bëhet gjithnjë e më rrallë. Në fakt, të dhënat statistikore nga vitet e kaluara tregojnë se shënojmë rritje të përqindjes së rasteve kur të akuzuarit në procedurë nuk i janë shpjeguar kushtet për ankesë për 5% në krahasim me vitin e kaluar. Konkretisht, në vitin 2016³⁶ mosshpjegim i këtyre kushteve nga gjykata është vërejtur në 24% të lëndëve, në vitin 2017³⁷ kjo përqindje është rritur në pothuajse 45%, ndërsa në vitin 2018 ajo arriti në 50% të numrit të përgjithshëm të shqyrtimeve të vëzhguara.

Përveç kësaj, temë e interesit tonë ishin edhe procedurat në të cilat personi i akuzuar nuk ka mbrojtës, për arsye se në situatat e tilla, konsiderojmë se gjykata duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë këshillave për të akuzuarit, veçanërisht për të drejtën dhe kushtet për ankesë. Lidhur me

³⁶Petrovska N., Misoski B., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2016, Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, OSBE, Shkup 2016

³⁷ Po aty

këtë çështje, vëzhguesit regjistruan vetëm 2 kundrejt 6 rasteve (siç mund të shihet në grafikun më poshtë) kur gjykata nuk ua ka shpjeguar të akuzuarve kushtet për ankesë.



Grafiku nr.64

■ PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- ◆ Akoma po vërehet një shkallë e lartë e shqyrtimeve të shtyra në të gjitha gjykatat. Megjithëse është vërejtur një përmirësim në praninë e të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës në procedurë, ka një tendencë negative në rritjen e shtyrjeve të shqyrtimeve për shkak të mungesës së prokurorit publik, gjyqtarit ose anëtarit të këshillit gjyqësor.

Rekomandim:

- Rritja e numrit të mungesave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve mund të jetë një tregues i burimeve të pamjaftueshme njerëzore në gjykatat dhe prokuroritë, prandaj është e nevojshme të bëhen analiza në lidhje me numrin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, por dhe të shërbimeve të tyre profesionale.
 - Është e nevojshme që AKMIS-i të koordinohet dhe të harmonizohet me oraret e aktiviteteve të të gjitha subjekteve në procedurë.
 - U vu re një nivel i lartë i mungesës së dëshmitarëve ose i palëve të dëmtuara në procedurë. Edhe pse bëhet fjalë për persona, prania e të cilëve nuk është e detyrueshme për mbajtjen e shqyrtimit, në përqindje të madhe këto mungesa ndikojnë në rrjedhën, gjegjësisht në dinamikën e zhvillimit të procedurës.
 - Koalicioni e përsërit rekomandimin për sigurimin e mjeteve adekuate për transportin e papenguar të personave të dënuar ose për të cilët është përcaktuar masa e paraburgimit deri në gjykatë.
- ◆ Është për t'u përhëndetur rritja e shqiptimit të masave më të lehta për sigurimin e pranisë, rënia në zbatimin e masës së paraburgimit, si dhe përqindja e përgjithshme e zbatimit të këtyre masave në vetëm 18% të të gjitha seancave të vëzhguara. Megjithatë, përkundër treguesve pozitivë statistikor, vërejmë favorizim të disa masave më të lehta, moszbatim të plotë të garancisë dhe zbatim të parregullt të paraburgimit shtëpiak.

Rekomandim:

- Ka nevojë për reformë të LPP-së dhe të Ligjit për shërbimin e provës, me qëllim të hapjes së mundësisë që shërbimet e provës të kenë kompetenca në aspekt të kontrollit dhe monitorimit të zbatimit efikas të masave më të lehta për sigurimin e pranisë. Në këtë mënyrë, gjykata do të fitonte një shërbim të specializuar që do t'i ofronte të dhëna adekuate për vlerësimin e rrezikut në lidhje me të akuzuarin dhe do të bënte mbikëqyrje profesionale mbi zbatimin e këtyre masave.
 - Përmirësimi i kapaciteteve të shërbimeve të provës dhe bashkëpunimi i tyre më i ngushtë me policinë, me qëllim të zbatimit të drejtë të kësaj kompetence të re eventuale.
- ◆ Për t'u përhëndetur është fakti se është zvogëluar numri i mbrojtësve që mungojnë gjatë seancave kur është dashur të përcaktohet ose kur është përcaktuar paraburgimi ndaj të personave të akuzuar. Megjithatë, edhe përkundër faktit se bëhet fjalë për një praktikë që nuk është harmonizuar me LPP-në, mjaft të shpeshta janë seancat në të cilat nuk është i pranishëm mbrojtësi i të akuzuarit në kushte kur është përcaktuar masa e paraburgimit, gjë që në masë të madhe e dëmton të drejtën e të akuzuarit për mbrojtje efikase.

Rekomandim:

- Reformë e LPP-së me qëllim që të sigurohet prani e detyrueshme e avokatit mbrojtës të të akuzuarit në të gjitha seancat kur të akuzuarit i është shqiptuar masa e paraburgimit.
- ◆ Vërehet një trend i braktisjes së fjalimeve hyrëse nga mbrojtësit, e poashtu është vërejtur edhe përgatitje e pamjaftueshme e prokurorëve sa i përket mbajtjes së fjalimeve hyrëse. Është vërejtur leximi i aktakuzës në vend të mbajtjes së fjalimit hyrës, por edhe nxjerrja dhe prezantimi i provave në fjalimin hyrës.

Rekomandim:

- Është e nevojshme të organizohen trajnime për subjektet në procedurë në lidhje me rëndësinë, nevojën dhe formën e mbajtjes së fjalimit hyrës.
- ◆ Janë vërejtur raste kur gjykata nuk i ka shpjeguar të akuzuarit se për çfarë është i akuzuar, madje edhe atëherë kur i akuzuari ka thënë se nuk e kupton se për çfarë akuzohet. Në lidhje me këtë, po ashtu është vërejtur se gjyqtarët nuk i këshillojnë të akuzuarit për të gjitha të drejtat që u takojnë në procedurën penale.

Rekomandim:

- Është e nevojshme të sensibilizohen gjyqtarët në lidhje me sqarimin e të drejtave, por edhe të veprës me të cilën ngarkohet personi i akuzuar. Është e nevojshme të ndryshohet praktika e interpretimit të dispozitave të LPP-së dhe zbatimi i tyre në praktikë që të mundësohet garanci për drejtësinë dhe objektivitetin e proceseve gjyqësore.
- ◆ Është vërejtur rënie serioze e numrit të pranimit të fajit gjatë shqyrtimit kryesor në gjitha gjykatat e vëzhguara. Në krahasim me vitet e mëparshme, rënie më drastike të pranimit të fajit ka në Gjykatat Themelore, Manastir, Veles dhe Shkup 1.
Është vërejtur korelacion ndërmjet peshës së veprës penale, politikës së ulët ndëshkuese të gjykatësve pas shqyrtimeve të mbajtura kryesore, rreptësisë dhe paparashikueshmërisë së sanksioneve në kushte kur është bërë pranimi i fajit, si dhe rolit të gjykatës dhe avokatit mbrojtës në vlerësimin e pranimit të fajit si faktorë negativë për zbatimin e kësaj procedure për përshpejtimin e shqyrtimit kryesor.

Rekomandim:

- Të bëhet një analizë e detajuar e faktorëve që ndikojnë në marrjen e vendimit nga të akuzuarit për ta pranuar fajin gjatë shqyrtimit kryesor.
- Rënia e zbatimit të procedurave të përshpejtuara, e në veçanti e procedurës për pranimin e fajit, mund të interpretohet si rënie e besimit ndaj gjykatës, dhe për këtë arsye është e nevojshme të ndërmerren hapa për ta përmirësuar imazhin publik të gjykatave. Në këtë drejtim, rekomandojmë trajnimin plotësues të gjyqtarëve dhe të mbrojtësve në lidhje me rolin e tyre gjatë pranimit të fajit.
- Përmirësimi i rolit të gjykatës në shpjegimin e thelbit të veprës penale për të cilën i akuzuari e ka pranuar fajin.
- Trajnime plotësuese për gjyqtarët për ta verifikuar pranimin vullnetar të fajit, si dhe vetëdijen për pasojat nga pranimi i fajit.
- Sensibilizimi i gjyqtarëve për mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarit në kushtet të pranimit të fajit në mungesë të avokatit mbrojtës në rastet e lejuara me ligj gjatë procedurës së shkurtuar.

- Rivlerësimi i nevojës për futjen e sistemit për parashikueshmërinë e sanksioneve në kushtet kur është pranuar faj, përmes udhëzimeve që janë në dispozicion publik dhe të padetyrueshme për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit, ose avancimin e sistemit AKMIS që të mund të ofrojë të dhëna statistikore për dënimin mesatar për një vepër të caktuar penale në kushte të rrethanave të ngjashme lehtësuese dhe rënduese.
 - Eliminimi i praktikave të kërcënimeve të fshehta nga ana e prokurorëve ndaj të akuzuarve, në veçanti përmes “pazarit” për zbatimin e masës së paraburgimit, parandalimi i tij nga gjykatësit dhe mospranimi i fajit në këto kushte.
- ◆ Kënaq fakti që kemi përmirësim në krahasim me vitin e kaluar në aspekt të mbështetjes me fakte të pranimit të fajit. Gjegjësisht, madje në 76% të rasteve kur të akuzuarit e kanë pranuar fajin, gjykata ka nxjerrë prova përkatëse për nga cilësia dhe sasia. Megjithatë, për fat të keq, ende prova më e shpeshtë është ekstrakti nga evidenca ndëshkuese.

Rekomandim:

- Reformë e LPP-së me qëllim të parashikimit të një seance të posaçme të provës për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit pasi të jetë pranuar faj.
- ◆ Për fat të keq, është regjistruar praktikë që në raste kur është bërë pranimi i fajit, përveç fajit gjykata të mos marrë vendim edhe për dëmin, gjë që e zvogëlon besimin e publikut te gjykata si arbitër efikas dhe i drejtë.

Rekomandim:

- Ndryshim i LPP-së me qëllim që, në rastet kur i akuzuari e ka pranuar fajin gjatë shqyrtimit kryesor dhe është kërkuar dëmshpërblim, gjykata, përveç për fajin, detyrimisht të marrë vendim në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim.
- ◆ Është vërejtur një devijim nga renditja ligjore e nxjerrjes së provave, gjegjësisht për shkak të ekonomizimit të procedurës, janë nxjerrë prova të mbrojtjes para se të nxirren provat e prokurorisë.

Rekomandim:

- Është e nevojshme të futen standarde, gjegjësisht barazim i praktikës së gjyqtarëve se kur dhe deri në ç’masë mund ta ndryshojnë renditjen e paraparë me ligj të nxjerrjes së provave mbi baza të ndryshme. Gjyqtarët duhet t’i shpjegojnë në detaje vendimet e tyre për ndryshimin e renditjes së nxjerrjes së provave, me qëllim që të sigurohen se ka barazi të armëve dhe se barra e provës nuk është transferuar mbi mbrojtjen.
- ◆ Është regjistruar rritje e trendit që marrja në pyetje në mënyrë të kryqëzuar të mos kufizohet në faktet e nxjerra gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje.

Rekomandim:

- Është e nevojshme të mbahen trajnime plotësuese për mënyrën e marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar, por edhe për mënyrën në të cilën gjykata duhet ta vlerësojë pranueshmërinë e pyetjeve gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të kryqëzuar. Sipas LPP-së, te ky lloj i marrjes në pyetje, kufizimi i vetëm është në aspekt të kufizimit të tij në faktet e nxjerra gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, por jo rrallë në praktikë vërehet se gjyqtarët, e po ashtu edhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, udhëhiqen sipas një modeli të veçantë, gjegjësisht e vlerësojnë pranueshmërinë e pyetje të kryqëzuara vetëm në bazë të fjalëve pyetëse të përdorura në pyetje.

- ◆ Është vërejtur trend i rritjes së përdorimit jo të drejtë të nenit 383, paragrafi 5 të LPP-së, më saktësisht, pyetjet e gjykatës janë shndërruar në marrje të veçantë në pyetje.

Rekomandim:

- Duhet bëhen qartësime plotësuese në LPP, si dhe trajnime të gjyqtarëve lidhur me të drejtën për t'u parashtruar pyetje dëshmitarëve dhe ekspertëve, me qëllim që të braktiset praktika inkuizitore për përcaktimin e fakteve. Është me rëndësi të veçantë të bëhet dallim midis sqarimit të rrethanave dhe përcaktimit të rrethanave të reja, ndërsa sipas parimeve të reja akuzuese të procedurës, ku paanësia dhe mospërfshirja e gjykatës në procedurë janë ngritur në një nivel më të lartë në krahasim me modelin e mëparshëm të procedurës inkuizitore.
- ◆ Është vërejtur praktikë jo e njëtrajtshme në aspekt të nxjerrjes së provave materiale. Kjo praktikë në masë të madhe është rezultat i mungesës së një dispozite në LPP, me të cilën do të rregullohej mënyra në të cilën nxirren provat materiale, dhe për këtë arsye në praktikë ka interpretime të ndryshme. Në fakt, një pjesë e gjyqtarëve i përdorin dispozitat e LPP-së së vjetër dhe i vetë i nxjerrin provat, ndërsa në një pjesë shumë të vogël provat janë nxjerrë nga ana e palës që i propozon ato.

Rekomandim:

- Koalicioni konsideron se në frymën e parimit akuzator të LPP-së aktuale, është e nevojshme të bëhen ndryshime në LPP, ose të bëhet barazimi i praktikës gjyqësore që të mundësohet që provat materiale t'i prezantojnë vetë palët që i propozojnë ato, edhe atë në mënyrën dhe kohën që ata do të përcaktojnë me listën e provave.
- ◆ Është vërejtur rritje e trendit që gjykata ta marrë në pyetje të akuzuarin, i cili e propozon veten si dëshmitar, mirëpo që nuk ka mbrojtës.

Rekomandim:

- Është e nevojshme të braktiset praktika e këtillë dhe në përputhje me parimet e lartpërmendura të akuzës dhe të kundërshtimit të LPP-së ekzistuese, që gjykata të mos lë përshtypje se është e anshme duke parashtruar pyetje që do të shkonin në favor të prokurorisë apo mbrojtjes.
- ◆ Është vërejtur përparim në lidhje me incizimin audio-vizual të shqyrtimeve, por megjithatë mbisundon mbajtja e procesverbalit duke diktuar nga ana e gjyqtarëve.

Rekomandim:

- Urgjentisht duhet të braktiset praktika e diktimit, gjegjësisht parafrazimit të pyetjeve dhe të dëshmimeve nga ana e gjyqtarit. Në këtë drejtim, është e nevojshme të ndahen mjete të duhura që të mundësohet incizimi audio-vizual i shqyrtimeve për ta forcuar objektivitetin, besueshmërinë dhe drejtësinë e procedurës.

- ◆ Brengos trendi i rritjes së trajtimit të pabarabartë nga gjykata ndaj prokurorit dhe mbrojtjes.

Rekomandim:

- Të avancohet roli i gjykatës përmes trajnimeve plotësuese dhe sensibilizimit të gjyqtarëve mbi rëndësinë e komunikimit ex parte midis gjykatës dhe palëve.
- ◆ Brengos trendi, i vërejtur edhe vitin e kaluar, i ekzistimit të zbatimit jo të drejtë të dispozitave të LPP-së në aspekt të përjashtimit të publikut nga shqyrtime të kryesore.

Rekomandim:

- Të bëhet përmirësimi ligjor i dispozitave të LPP-së me të cilat rregullohet prania e publikut gjatë shqyrtimeve kryesore, me qëllim që ato të zbatohen në mënyrë konsekuente, veçanërisht duke marrë parasysh rëndësinë e publikut për ta rritur besimin në pavarësinë e pushtetit gjyqësor.
- ◆ Brengos trendi i përkeqësimit të të dhënave të vitit të kaluar në lidhje me publikimin në kohë të vendit dhe kohës së gjykimeve.

Rekomandim:

- Të rriten investimet në kapacitetet njerëzore dhe teknike të gjykatave.
- ◆ Vërehet prania e praktikës që gjyqtarët të kenë rol aktiv gjatë shqyrtimit kryesor. Në këtë mënyrë, te publiku fitohet përshtypja se bëhet fjalë për gjyqtarë të njëanshëm, ose bile edhe hakmarrës.

Rekomandim:

- Zbatimi konsekuent i dispozitave të LPP-së në aspekt të rolit të gjykatës gjatë shqyrtimit kryesor.
- ◆ Kënaq fakti që ka përmirësim në perceptimin e vëzhguesve sa i përket efikasitetit të mbrojtjes që e kanë marrë të akuzuarit nga mbrojtësit e tyre. Megjithatë, për fat të keq, kemi rritje të ankesave të mbrojtësve në lidhje me qasjen në prova.

Rekomandim:

- Zbatimi konsekuent i dispozitave të LPP-së dhe eliminimi i praktikës së gjykatës për kufizimin e të drejtës së qasjes së mbrojtësve në të gjitha provat, veçanërisht gjatë shqyrtimit kryesor, si dhe eliminimi i praktikës së qasjes selektive në provat në kushtet kur ka më tepër persona të akuzuar.
- ◆ Kënaq fakti që gjykata ka pasur mirëkuptim më të madh për nevojat e mbrojtësve në lidhje me kohën për përgatitjen e mbrojtjes, si dhe përmirësimi në krahasim me vitin e kaluar edhe sa i përket të drejtës së të akuzuarit për ta gëzuar të drejtën për ndihmë juridike falas.
- ◆ Është për t'u përhëndetur fakti se disa vite me radhë nuk mund të jemi dëshmitarë të diskriminimit nga gjykatat në bazë të racës ose gjinisë.
- ◆ Për t'u lavdëruar është edhe praktika që gjyqtarët nuk kanë nxjerrë përfundim negativ për të akuzuarin i cili është mbrojtur me heshtje.

NGO Coalition “All for Fair Trials” – Skopje
OSCE Mission to Skopje

Prof. Boban Misoski, PhD, Faculty of Law “Justinianus Primus”, Skopje
Darko Avramovski
Natali Petrovska, attorney at law

ANALYSIS
OF THE DATA COLLECTED
FROM THE COURT PROCEEDINGS
MONITORED IN 2018

Authors

Prof. Boban Misoski, PhD, Faculty of Law “Justinianus Primus”, Skopje

Darko Avramovski

Natali Petrovska, attorney at law



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission to Skopje

The content of this publication does not necessarily represent the views or the position of the OSCE Mission to Skopje.

Skopje, December 2018

■ INTRODUCTION

The Coalition "All for Fair Trials" is a network composed of 14 domestic organizations whose principal mission is to monitor court proceedings in the country in order to promote respect for fair trial standards before domestic courts, identify inherited problems in the judicial system, point out the needs for legal and institutional reform, familiarize the public with the fair trial standards, strengthen the confidence of citizens in the institutions of the judicial system as well as reduce the possibilities of improper treatment of the stakeholders in the court proceedings by judges or other participants in the procedure.

Because of that, and as a result of the initiation of the reform process in the judiciary, which directly or indirectly impacts the performance of courts, the Coalition in 2018, as well as during the previous 3 years, implemented the project "Supporting Judicial and Criminal Justice Reforms" through financial support of the OSCE Mission to Skopje. While implementing the project activities, emphasis was placed on initiating public debate, especially among the expert public regarding the processed data, collected by monitoring court proceedings over the past 3 years. To that goal two public events were organized in the form of round tables attended by representatives of the Coalition and the OSCE Mission, Basic Court judges, public prosecutors, attorneys, representatives of the Council of Europe, as well as civil sector and media representatives. This analysis is prepared as part of the project activities and the analysis itself deals with processing of data collected in the course of 2018, it contains a short overview of the state of affairs in the judiciary, as well as recommendations for promoting and strengthening the independence, efficiency and effectiveness of court proceedings.

■ METHODOLOGY

For the needs of this analysis the collection of data was performed through a field research, that is through physical presence of Coalition monitors in the courtrooms of 9 Basic Courts in all four appellate regions. To that goal 16 professional monitors were engaged and these monitors were represented by graduated lawyers having many years of experience and more detailed knowledge of the criminal law, especially with respect to the current Law on Criminal Procedure. For the purpose of this research, a one-day training was organized for monitors, whereupon the monitors were dispersed in courtrooms where they monitored hearings in capacity of public. The monitors were guided by the principles of objectivity and non-interference, and they were also bound by the principle of confidentiality.


The cases subject to our monitors' research were selected randomly, efforts were made to comprise a representative sample, that is to include proceedings that were conducted for different criminal acts according to the average representation of crimes in court proceedings which is published in the annual reports on the performance of courts, as well as the annual Coalition's analyses.

For the purpose of the research a special and systematized questionnaire was created where the monitors entered the collected data.. This questionnaire is modified and adapted annually, according to the needs of the research, by reformulating certain questions or by adding new questions in order to assure greater accuracy of the collected data, as well as to comprise additional indicators of concrete newly-detected situations requiring a more comprehensive research. The questionnaire is composed of 75 questions referring to general data of the case monitored as well as the course

of the main hearing, having monitors the monitors properly following the application of the court procedure while focusing on several institutes marking the transit from the inquisitorial into accusatorial criminal procedure. The questions are conceptualized in such a way as to enable inclusion of qualitative and quantitative indicators of the extent of application of the Law on Criminal Procedure (LCP) and the ratified international documents regulating the right to a fair trial. The closed questions, offering two or more answers, predominate in the questionnaire and they allow for mechanic and statistical processing of certain trends noted as problematic or positive in the application of LCP. These questions are supplemented with several open questions, where monitors can narratively clarify certain answers, give their views, and notify about facts for which no specific question has been provided in the questionnaire. In this way, it is possible to include more qualitative indicators of the procedure, so that the data obtained by the monitors provide a clear, immediate, objective and transparent picture of the criminal case or hearing that is subject to monitoring.

■ GENERAL DATA


In order to more broadly distribute the project activities, especially with respect to the component dealing with monitoring of criminal cases, a network of monitors was created and distributed across all four appellate regions, comprising the courts as follows: Skopje, Veles, Tetovo, Bitola, Prilep, Shtip, Strumica, Ohrid and Kumanovo. A total number of 415 court hearings or 300 criminal cases were monitored within this process. Given the size and scope of work, the highest number of hearings or cases were monitored in the Basic Court Skopje 1 in Skopje - 108, Veles - 48, Tetovo-25, Bitola - 73, Prilep-25, Shtip-27, Strumica-25, Ohrid-56 and Kumanovo-28 (Graph. no.1). The monitoring was conducted within a period of 7 months, starting from April 2018 until end November, for the purpose of collecting as much data as possible that can enable us to reach conclusions, create guidelines and recommendations.



Graph no.1

The criminal acts registered in the monitored cases are as much diverse as they were in the past years, but the particular fact is that the same variations of criminal acts have been repeating for four

consecutive years now, and these refer to crimes committed against the property and body, crimes against public order, crimes in relation to official duty and similar (graph no.2).



Graph no.2

POSTPONEMENT OF HEARINGS

Principal requirement for holding a main hearing is the presence of the summoned persons. The failure of a person to appear in court, despite the fact that he has been dully summoned, can cause various consequences and different actions by the court, depending on the capacity of the person that is absent from the main hearing¹.

Depending on whether it is about a public prosecutor (PP) or a private plaintiff which although dully summoned failed to appear in court the law envisages different consequences. If the public prosecutor fails to appear at the hearing and fails to justify his absence, then he shall be imposed a penalty, while if a private plaintiff fails to appear at a hearing and fails to justify his absence, the consequences are much more severe - the court shall make a decision on terminating the procedure. Whatever the case, the main hearing can be conducted only in presence of authorized prosecutor.


On the other hand, the presence of the defendant during the main hearing represents a basis of the right to a fair trial and hence it is unthinkable to conduct proceedings in absence of someone who is "tried". However, the law envisages exceptions to this rule and they refer to situations: 1) when

¹ Kalajdziev G., Lazhetikj G., Nedelkova L., Denkovska M., Trombeva M., Vitlarov T., Jankulovska P., Kadiev D., A Comment on the Law on Criminal Procedure, OSCE, Skopje, 2018.

